EPOKA E RE
E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5815
E hënë, 1 korrik 2019
çmimi 0.40 €

## Pjesëmarrje e ulët në zgjedhjet lokale në Shqipëri

FAQE 2




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", ADRI NURELLARI FAQE 4-5



# Kthimi i Rusisë minimizon gjasat e Kosovës për anëtarësim në Këshill të Evropës

Njohësi i marrëdhënieve ndërkombëtare, Adri Nurellari, ka bërë me dije se kthimi i Rusisë në Këshill të Evropës minimizon gjasat e Kosovës për t'i siguruar votat e duhura në Asamblenë Parlamentare (PACE) të kësaj organizate. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se Kosova ka pasur një shans historik për ta nisur procesin e anëtarësimit në këtë organizatë gjatë kohës kur Rusia ishte jashtë saj. Nurellari e ka dënuar kthimin e Rusisë në Këshill të Evropës, duke theksuar se kjo situatë tregon se Evropa ka rënë pre e shantazhit të Rusisë. Sipas tij, kjo dëshmon se Evropa nuk është më e njëjta

## Njazi Thaçi: Me gjithë vështirësitë, KEK-u po operon në kuadër të objektivave

FAQE 8-9

Drejtori i Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), Njazi Thaçi, ka thënë se, pavarësisht prej sfidave me të cilat është duke u ballafaquar kjo korporatë, janë duke operuar në kuadër të objektivave për nxjerrjen e thëngjillit dhe prodhimit të energjisë elektrike. Duke folur rreth protestës së punëtorëve të kësaj korporate, Thaçi ka thënë se vazhdimisht i ka përkrahur kërkesat e sindikatave dhe ka bërë me dije se do të plotësohen kur ka mundësi. "Të gjithë jemi njëzëri se punëtori është aseti më i rëndësishëm i KEK-ut", ka thënë Thaçi





## Haradinaj në Paris kërkon mbështetje për liberalizim të vizave

FAQE 3

### AKTUALE



IKSHPK-ja, THIRRJE QYTETARËVE: KUJDES KU PO USHQEHENI! F. 6

KUVENDI DEBATON PËR LUGINËN E PRESHEVËS F. 7

MBI 20 MIJË TONË BARNA PA AFAT MBAHEN NË DEPO F. 11




### EKONOMI

MILIARDAT E KOSOVËS NË TREGJET BOTËRORE F.9



### SPORT

'DUGI', MES DUKAGJINIT DHE BESËS F. 16



RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Pjesëmarrje e ulët në zgjedhjet lokale në Shqipëri

Të dielën në Shqipëri është votuar në mënyrë të qetë për kryebashkiakët e 61 bashkive. Pjesëmarrja në këto zgjedhje ka qenë e ulët dhe janë mbajtur pa partitë kryesore opozitare në vend dhe në kushte jo të zakonshme, me masa të larta të sigurisë nga forcat policore dhe me ndasi të thellë mes të gjithë akterëve politikë të Shqipërisë, duke e vendosur në pikëpyetje vlefshmërinë e tyre




TIRANË, 30 QERSHOR - Të dielën në Shqipëri janë mbajtur zgjedhjet lokale pa ndonjë incident në 61 bashki, ku qytetarët i kanë votuar kryebashkiakët e tyre në zgjedhjet lokale, megjithëse këto zgjedhje janë mbajtur pa partitë kryesore opozitare në vend.
Këto votime janë mbajtur në kushte jo të zakonshme, me masa të larta të sigurisë nga forcat policore dhe me ndasi të thellë mes të gjithë akterëve politikë të Shqipërisë, duke e vendosur në pikëpyetje vlefshmërinë e tyre.
Qytetarët e Shqipërisë duket se janë vënë mes vendimit për t'i zgjedhur kryetarët e bashkive, apo për të zgjedhur të bojkotojnë totalisht këto zgjedhje.
Sipas të të dhënave të KQZ-së, në rang Republike, nga 3.5 milionë shqiptarë me të drejtë vote e kanë shfrytëzuar të drejtën për të zgjedhur kryetarët e rinj të bashkive vetëm 19.4% e tyre, kurse rezultatet preliminare pritet të shpallen sot (e hënë).
Zyrtarë të Partisë Demokratike e kanë konsideruar procesin e së dielës si të dështuar dhe flasin për një pjesëmarrje shumë më të ulët sesa nga ajo që raporton KQZ, e cila është vënë në dyshim edhe nga vetë kryetari i këtij institucioni, Klement Zguri.
Partia Demokratike u ka bërë një thirrje institucioneve dhe medieve ndërkombëtare për parregullsitë e konstatuara gjatë procesit të votimit.
Me anë të një postimi në Twitter ata i janë drejtuar institucioneve të Bashkimit Evropian, sekretarit amerikan të Shtetit dhe disa prej medieve më prestigjioze në gjithë botën, ku i listojnë disa nga problematikat në zgjedhje.
Këto ata i kanë në formën e një dosjeje me fotografi dhe video që dëshmojnë shkeljet gjatë procesit zgjedhor.
Opozita kishte deklaruar se nuk do të lejonte zhvillimin e zgjedhjeve dhe u ka bërë thirrje qytetarëve që "të mos marrin pjesë në një proces farsë".
Krerët opozitarë kanë thënë se këto nuk janë zgjedhje, por vetëm votim për një parti.
Megjithatë, kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha u ka bërë thirrje qytetarëve të distancohen nga dhuna.
"Ndryshe nga Edi Rama që, për pushtetin e tij personal, është i gatshëm t'i çojë të dielën shqiptarët në vëllavrasje, unë kam përgjegjësinë për jetën e çdo demokrati, çdo socialisti, çdo qytetari shqiptar. Ndaj për të dielën unë kam vetëm një thirrje: Mos bini pre e instinktit të dhunës! Mos bini pre e provokimeve për dhunë", ka shkruar Basha një ditë më herët.
Presidenti i Shqipërisë Ilir Meta, i cili ka anuluar zgjedhjet e së dielës, ka caktuar një datë të re të zgjedhjeve lokale në vend. Ai bëri të ditur se ka dekretuar 13 tetorin si ditë kur qytetarët e Shqipërisë do të votojnë për kryetarët e bashkive të tyre.
Megjithatë, Partia Socialiste ka shpërfillur vendimin e presidentit dhe e ka quajtur atë jokushtetues, duke vazhduar fushatën zgjedhore e vetme.
Përgjatë krejt fushatës, PS-ja u prit me protesta nga qytetarët, të cilët edhe dogjën materialet nëpër disa qendra të votimeve në Shqipëri.
Presidenti, një ditë më herë ka bërë thirrje për qetësi për ditën e diele. Presidenti Meta kërkoi nga qytetarët "vetëpërmbajtje dhe sjellje civile e demokratike" gjatë të dielës.
Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama duke iu referuar zgjedhjeve të 30 qershorit, në një intervistë për Radion Evropa e Lirë tha se ai dhe partia e tij janë të gatshëm për dialog me opozitën, por se "nuk negociojnë demokracinë".
Që nga muaji shkurt, opozita organizoi vazhdimisht protesta në Tiranë me kërkesën për largimin e kryeministrit Edi Rama, duke e konsideruar atë të papranueshëm që të jetë në krye të Qeverisë shqiptare në kohën e mbajtjes së zgjedhjeve.
Kërkesat dhe protestat e opozitës për largimin e kryeministrit Edi Rama, janë intensifikuar edhe pas publikimit të përgjimeve telefonike nga gazeta gjermane "BILD" ku dëgjohen politikanë socialistë dhe ish-ministra të Qeverisë Rama që diskutojnë për rezultate maksimale të votimeve, dhe dyshohen të jenë të përfshirë në manipulim të procesit zgjedhor.
E diela njihet si datë zyrtare e zgjedhjeve edhe nga bashkësia ndërkombëtare dhe ambasadat me seli në Tiranë. Ata, po ashtu kanë bërë thirrje për lejim të qytetarëve të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar dhe për mbarëvajtje të këtij procesi pa tensione dhe qetësi.

## Merkeli: Kosova e Serbia ta ndjekin guximin politik të Shkupit e Athinës



BERLIN, 30 QERSHOR - Kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel, ka theksuar se rajoni i Ballkanit Perëndimor ka një perspektivë evropiane, por ende ka shumë kushte për t'i përmbushur.
"Shumë shtetas gjermanë kanë marrëdhënie personale me njerëzit e Ballkanit Perëndimor, shumë njerëz nga Ballkani Perëndimor jetojnë në Gjermani dhe përfaqësojnë një urë midis atyre vendeve. Qytetarët e këtij rajoni janë fqinjët tanë dhe perspektiva e tyre është të bëhen pjesë e BE-së, nëse ata i plotësojnë të gjitha kushtet", ka thënë Merkeli.
Ajo ka thënë se edhe pse konfliktet ushtarake të viteve 1990 janë tejkaluar, ka ende mosmarrëveshje të hapura për t'u zgjidhur në ato vende.
Në një video të postuar me rastin e Samitit të ardhshëm të Ballkanit Perëndimor, i cili si pjesë e procesit të Berlinit do të mbahet të premten, në qytetin polak Poznan, Merkeli ka shpjeguar se qëllimi është për t'i hapur bisedimet midis vendeve përmes të cilave ato do të arrijnë një bashkëpunim më të mirë, përcjell reporteri.
"Sot situata në Ballkanin Perëndimor është e qetë, por ka sfida që duhet të zgjidhen dhe është e nevojshme për t'i përmbushur kushtet për përgatitjen e vendeve për pranimin në BE. Rruga është akoma e çrregullt", ka deklaruar Merkeli, duke shtuar se në rajon ka shembuj pozitivë të dialogut, veçanërisht duke theksuar zgjidhjen e kontestit të në mes të Shkupit dhe Athinës rreth emrit.
"Me guxim politik, kryeministrat e Maqedonisë Veriore Zoran Zaev dhe ai i Greqisë Aleksis Tsipras kanë dëshmuar se mund të zgjidhen konfliktet, dhe me këtë rast i kanë hapur Maqedonisë Veriore perspektivën për t'i filluar negociatat e pranimit me BE dhe hyrjen e vendit në NATO.
Një shembull i tillë pozitiv duhet të jetë inkurajim për t'i zgjidhur problemet në Bosnjë e Hercegovinë, si ndërmjet Serbisë dhe Kosovës", ka theksuar Merkeli.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka mbajtur Kuvendin e Punës

# Haradinaj në Paris kërkon mbështetje për liberalizim të vizave

Kryeministri Ramush Haradinaj ka udhëtuar për në Paris dhe do të kërkojë mbështetje nga zyrtarët francezë për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Haradinaj sot (e hënë) do të pritet në takim nga ministri i Brendshëm i Francës, Christophe Castaner, me të cilin do të bisedojë për ecurinë e procesit të liberalizimit të vizave. Kryeministri Haradinaj ka shprehur optimizëm se Bashkimi Evropian do t'i liberalizojë vizat për qytetarët e Republikës së Kosovës



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

**Prishtinë, 30 qershor** - Shefi i Qeverisë së Kosovës, Ramush Haradinaj, po qëndron për vizitë zyrtare në Paris, për të kërkuar mbështetje për heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës. Haradinaj sot (e hënë) do të takohet me ministrin e Brendshëm të Francës, Christophe Castaner, me të cilin do të diskutojë për liberalizimin e vizave.

Kryeministri ka shprehur optimizëm se Bashkimi Evropian do t'i liberalizojë vizat për qytetarët e Republikës së Kosovës meqë vendi ynë i ka plotësuar të gjitha kriteret. "Ne i kemi përmbushur kriteret e liberalizimit të vizave dhe nga Evropa presim që të marrë vendimin ashtu siç na tha po Gjermania. Sot udhëtoj për Paris. Do të kem takime vetëm për këtë temë, sepse Kosova është gati dhe e ka kryer punën e vet. Pra, do të takohem me ministrin e Brendshëm të Francës, Christophe Castaner, me të cilin do të diskutojmë për liberalizimin e vizave. Në këtë vizitë do të zhvilloj takime edhe me përfaqësues të tjerë institucionalë dhe politikë të Francës, me qëllim të thellimit të bashkëpunimit bilateral dhe për kërkimin e mbështetjes për avancimin e agjendës evropiane të vendit", ka deklaruar Haradinaj në Kuvendin e Punës së Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

Në këtë aktivitet partiak Haradinaj ka folur edhe për zhvillimet e tjera politike në vend, me ç'rast ka përmendur të arriturat e Kosovës gjatë mandatit të tij qeverisës. Formimi i ushtrisë së Kosovës, taksa ndaj produkteve serbe si dhe përmbysja e idesë për korrigjimin e kufijve, sipas tij, janë ndër të arriturat kryesore. "Janë disa çaste kyçe që e bëjnë politikën tonë të qëndrueshme, madje edhe historike. Ne kemi përmbyllur periudhën e sigurisë duke i dhënë mandat mbrojtës Ushtrisë së Kosovës. Tash Kosova e ka ushtrinë e vet. Ne arritëm ta delegjetimojmë idenë e korrigjimit të kufijve që në thelb e hidhte poshtë vendimin e GjND-së dhe pakon e Ahtisarit, duke suspenduar Kushtetutën tonë e që realisht do të rezultonte edhe me shpërbërjen e shtetit të Kosovës. Me taksën 100 për qind i treguam botës që jemi të zot të vetvetes dhe nuk lejojmë as Serbinë, e as një shtet tjetër ta rrezikojë Kosovën", është shprehur Haradinaj, duke shtuar se gjatë këtyre 20 muajve në qeverisje ka arritur ta konsolidojë sistemin e drejtësisë, fuqizimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve me dyfishim të pagës. "Të gjithë u kthyem në përkrahje të rendit dhe ligjit. Askush nuk është mbi ligjin. Kosova tash ka gjyqësorin e pavarur dhe është kompetent për ta luftuar krimin", ka theksuar ai.

Paralelisht kësaj, Haradinaj ka thënë se qeveria nën drejtimin e tij i është qasur zhvillimit ekonomik. Sipas tij, përmes taksës 100 për qind janë mbështetur prodhuesit vendorë, janë rritur punësimet si dhe janë rritur prodhimi dhe konsumimi i produkteve tona. "Kemi krijuar zona ekonomike në gjithë vendin, u kemi dhënë prona komunave dhe u kemi dhënë fuqi vendimmarrëse kryetarëve të komunave. Tani komunat janë partnere në zhvillim ekonomik. Ka rritje ekonomike prej 4.7 përqindësh dhe është një buxhet i rritur për 15.7 për qind. Do të veprojmë më tutje për thellimin e reformave fiskale duke liruar nga tatimi lëndën e parë dhe do të marrim veprime të tjera që shkojnë në përkrahje të sipërmarrësve të vendit. Kemi nënshkruar kontratën për 'Kosovën e Re', njëkohësisht kemi përmbyllur autostradën 'Arbën Xhaferi' dhe kemi filluar autostradat e tjera, atë për Luginë dhe për Dukagjin. Jemi në nisje të renovimit të hekurudhave të Kosovës. I kemi dhënë Trepçës statutin e shumëpritur dhe zgjuam nga gjumi gjigantin tonë. Tash kjo pasuri është gati për investime, për vende pune dhe ngritje të mirëqenies", ka thënë Haradinaj.

Ndërsa në planin social, ai ka thënë se qeveria ka rritur pagat për policët, ushtarët, mësuesit, mjekët dhe për punëtorët socialë. "Tash Kosova është më se miri në rajon me paga", ka deklaruar kryeministri, duke shtuar se normalizimi i raporteve Kosovë - Serbi mund të arrihet vetëm me marrëveshje për njohje në kufijtë ekzistues. "Në Bruksel dialogu për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë devijoi në dialog për kufij dhe territore, por tani presim një kornizë marrëveshje përfundimtare që rezulton me njohje reciproke në kufijtë ekzistues. Jemi këtu për t'i kryer punët e këtij vendi dhe për ta bërë Kosovën shtet siç duhet dhe për t'iu treguar të gjithëve në rajon se si shtet mund të punoni me ne dhe së bashku si shtete sovrane mund të vazhdojmë drejt BE-së", ka thënë Haradinaj.

Gjithashtu, kryeministri Haradinaj ka paralajmëruar realizimin e projektit Prishtina e re që, sipas tij, është pronë e përbashkët e qeverisë dhe komunës. "Do të jetë projekti më i madh ndërtimor në Evropën Juglindore. Do të ndërtojmë në Kosovë mbi një milionë metra katrorë. Në këto metra katrorë do t'i ndërtojmë të gjitha institucionet e Kosovës", ka theksuar kryeministri Haradinaj.

## Haradinaj: AAK-ja do të dalë partia e parë në Kosovë

Ndërsa duke folur për konsolidimin e AAK-së në terren, kryetari Ramush Haradinaj beson se kjo parti do të dalë partia e parë në Kosovë pas zgjedhjeve. "Për dallim prej cilësdo parti politike në Kosovë, vetëm AAK-ja mund të ecë në krijimin e një vlere të re, pra të krijojë atë që i mungon Kosovës, e kjo është më shumë rend, ligj e siguri si dhe më shumë sovranitet e më shumë zhvillim ekonomik. Edhe si parti ne po rritemi bashkë me shtetin tonë. A ka ndonjë pengesë që na ndal? Jo, nuk ka. Ne mund ta ndalim vetëm vetën. Por nëse ne nuk ndalim vetën, AAK-ja do të dalë partia e parë në Kosovë", ka theksuar Haradinaj.

Në Kuvendin e Punës Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është bërë me Departamentin e Gruas, Akademinë Politike, Kodin e Etikës si dhe me Platformën e Zhvillimit Ekonomik. Kuvendi ka miratuar edhe sloganin e partisë që është propozuar nga kryetari i saj Ramush Haradinaj "Ne guxojmë me krijue".



## Shukri Buja ftohet nga Gjykata Speciale

**Prishtinë, 30 qershor** - Shukri Buja, ish-komandanti i UÇK-së nga Zona Operative e Nerodimes, është i ftuari i radhës nga Gjykata Speciale. Buja për "Insajderin" ka konfirmuar se ka marrë ftesën dhe do të gjykohet në cilësinë e të dyshuarit. "Jam ftuar nga prokurori i Prokurorisë Speciale, në cilësinë e të dyshuarit. Më 17 korrik duhet të paraqitem", ka thënë Buja.

Gjykata Speciale ishte krijuar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës pas publikimit të raportit të Dick Martyt, i cili pretendonte se ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kanë kryer krime.

Flet për "Epokën e re", Adri Nurellari

# Kthimi i Rusisë minimizon gjasat e Kosov



Njohësi i marrëdhënieve ndërkombëtare, Adri Nurellari, ka bërë me dije se kthimi i Rusisë në Këshill të Evropës minimizon gjasat e Kosovës për t'i siguruar votat e duhura në Asamblenë Parlamentare (PACE) të kësaj organizate. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se Kosova ka pasur një shans historik për ta nisur procesin e anëtarësimit në këtë organizatë gjatë kohës kur Rusia ishte jashtë saj. Nurellari e ka dënuar kthimin e Rusisë në Këshill të Evropës, duke theksuar se kjo situatë tregon se Evropa ka rënë pre e shantazhit të Rusisë. Sipas tij, kjo dëshmon se Evropa nuk është më e njëjta

EPOKA E RE Muhamet KOCI

**Prishtinë, 30 qershor** - Njohësi i marrëdhënieve ndërkombëtare, Adri Nurellari, e ka dënuar kthimin e Rusisë në Këshill të Evropës. Ai ka paralajmëruar se një veprim i tillë do t'i sjellë probleme Kosovës në procesin e anëtarësimit në këtë organizatë, e cila mision ka mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe demokracisë.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Nurellari ka thënë se tani gjasat e Kosovës për t'i siguruar votat e duhura në Asamblenë Parlamentare (PACE) të kësaj organizate bëhen minimale. "Me kthimin e Rusisë në Këshill të Evropës, gjasat e Kosovës për t'i siguruar votat e duhura në asamblenë parlamentare (PACE) të kësaj organizate bëhen minimale. Kjo do të thotë se ne kemi pasur një shans të rëndësishëm historik të periudhës kur Rusia nuk ka qenë pjesë e kësaj organizate për ta nisur procesin e anëtarësimit dhe për të lobuar për t'u votuar nga PACE", ka thënë Nurellari.

Ai ka vlerësuar se institucionet e Kosovës është dashur të bëjnë më tepër gjatë kohës sa Rusia ka qenë e përjashtuar nga kjo organizatë. "Fatkeqësisht, Kosova në vend se të angazhohej për t'u anëtarësuar në këtë organizatë, gjatë kësaj periudhe është fokusuar në problemet e brendshme dhe ka qenë e gozhduar nga një klimë e konfliktit të brendshëm që u karakterizua nga ngërçi, protestat për demarkacionin dhe asociacionin dhe u degradua në banalitetin dhe agresivitetin e gazit lotsjellës, molotovit, vezëve dhe makinave të ndezura ndaj oponentëve e deri tek zola ndaj Kuvendit të Kosovës", është shprehur ai.

Nurellari ka kundërshtuar vendet që kanë votuar pro rikthimit të Rusisë në këtë organizatë.

Sipas tij, kjo është një ngjarje shumë e rëndë sepse thelbi i kësaj organizate janë të drejtat e njeriut, ndërsa Rusia është një ndër shkelëset më flagrante të këtyre të drejtave. "Kjo situatë jo vetëm se tregon se Evropa ka rënë pre e shantazhit, por dëshmon edhe që Evropa nuk është më e njëjta. Pra, duket qartazi se ndryshimet e fundit tektonike që kanë ndodhur me klimën e opinionit dhe sistemet partiake të vendeve kryesore evropiane po japin impaktin e tyre në orientimin e Evropës për sa iu përket parimeve dhe vlerave të demokracisë dhe lirisë. Konkretisht, kjo zmbrapsje nuk duhet parë vetëm si një inferioritet ndaj kërcënimit të Rusisë, por edhe si një dëshmi që konsolidimi i partive jokonvencionale populiste të ekstremit të majtë e të djathtë ka ndryshuar edhe kompozimin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës", ka thënë Nurellari.

**"Epoka e re:** *Z. Nurellari, Këshilli i Evropës javën e kaluar ka votuar për rikthimin e Rusisë në këtë institucion, i cili rol primar ka të drejtat e njeriut në kontinent. Cili është mendimi juaj për këtë veprim?*

**Nurellari:** Për mendimin tim, kjo është një ngjarje shumë e rëndë sepse në fund të fundit zanafilla dhe thelbi i kësaj organizate janë pikërisht të drejtat e njeriut dhe Rusia është një ndër shkelëset më flagrante të tyre. Po ashtu, nuk ka ndonjë

# ës për anëtarësim në Këshill të Evropës



riparim, pendesë apo ndryshim të Rusisë lidhur me shkaqet për të cilat u sanksionua dhe u largua nga kjo organizatë, prandaj është pakuptueshme pranimi i rikthimit. E gjitha kjo situatë ta kujton të kaluarën e turpshme evropiane të traktatit të Mynihut, ku forcimit dhe kërcimit të Hitlerit, Evropa iu përgjigj me zmbrapsje dhe akomodim të interesave duke mbyllur sytë si struci ndaj rrezikut që regjimi nazifashist po i afronte Evropës. Vitin e kaluar u mbushën 80 vjet nga marrëveshja famëkeqe e Mynihut mes katër fuqive evropiane: Gjermanisë, Italisë, Britanisë së Madhe dhe Francës, ku u lejua pushtimi i Çekosllovakisë me iluzionin anglezo-francez se Hitleri do të mjaftohej me aq. Ajo zbythje ndaj Gjermanisë hitleriane konsiderohet një nga ngjarjet kryesore që favorizuan shpërthimin e Luftës së Dytë Botërore duke e shtyrë Rajhun e Tretë drejt ekspansionit territorial në Evropë. Me sa duket, Evropa nuk ka nxjerrë mësime nga pësimet dhe tregohet inferiore ndaj kujtdo që tregon dhëmbët e dëshmon gatishmëri për ta përdorur dhunën. Ne si Kosovë e kemi parë këtë gjë edhe me Serbinë, ku Beogradi shpesh akomodohet apo kënaqet prej Brukselit vetëm sepse kërcënon me destabilizim potencial nëpërmjet trazirave që mund të shkaktojë me pakicat serbe që ka në Bosnje Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi dhe Maqedoni.

**"Epoka e re":** *Në vitin 2014 Rusisë iu kishte hequr e drejta e votimit në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës si ndëshkim për aneksimin e gadishullit ukrainas të Krimesë. Nga atëherë Rusia vazhdimisht ka kërcënuar me largim nga KE-ja nëse nuk i kthehet e drejta e votimit. I bie kjo që vendet evropiane kanë rënë pre e shantazhit të Rusisë?*

**Nurellari:** Kjo situatë jo vetëm se tregon se Evropa ka rënë pre e shantazhit, por dëshmon edhe që Evropa nuk është më e njëjta. Pra, duket qartazi se ndryshimet e fundit tektonike që kanë ndodhur me klimën e opinionit dhe sistemet partiake të vendeve kryesore evropiane po japin impaktin e tyre në orientimin e Evropës për sa iu përket parimeve dhe vlerave të demokracisë e lirisë. Konkretisht, kjo zmbrapsje nuk duhet parë vetëm si një inferioritet ndaj kërcënimit të Rusisë, por edhe si një dëshmi që konsolidimi i partive jokonvencionale populiste të ekstremit të majtë e të djathtë ka ndryshuar edhe kompozimin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës duke krijuar një situatë ku numri i deputetëve që vijnë nga këto parti është shtuar ndjeshëm, aq sa të ketë efekt vendimtar në procesin e votimit. Përpos kësaj, kemi të bëjmë edhe me një ndryshim interesant në strategjinë e Rusisë ndaj Evropës. Pasi e ka parë që nuk ia ka dalë dot ta bllokojë zgjerimin e NATO-s në Ballkan, me tentativat e dështuara për puç në Mal të Zi, por edhe për konflikt ndëretnik në Maqedoni, Rusia po sheh si plan B investimin e ndërtimit të lidhjeve me politikanët dhe partitë populiste. Pra, me sa duket, nuk dëshiron të përballet më në mënyrë frontale, por nëpërmjet kuajve të Trojës që përbëhen nga parti që kanë marrë financime të errëta e të dyshimta nga Moska ose që kanë shprehur simpati dhe mbështetje për autoritarizmin e Putinit. Kështu që këtë votë e shoh edhe si demonstrim i këtij ndryshimi taktik të Rusisë përkundrejt Evropës. Me pak fjalë, jo më konfrontim ballë për ballë, por infiltrim dhe infektim përbrenda sistemit.

**"Epoka e re":** *Kosova është në përgatitje për të aplikuar për anëtarësim në këtë organizatë. Në këtë drejtim, sa vështirësi mund të paraqesë rikthimi i Rusisë?*

**Nurellari:** Me kthimin e Rusisë në Këshill të Evropës gjasat e Kosovës për t'i siguruar votat e duhura në asamblenë parlamentare (PACE) të kësaj organizate bëhen minimale. Kjo do të thotë se ne kemi pasur një shans të rëndësishëm historik të periudhës kur Rusia nuk ka qenë pjesë e kësaj organizate për ta nisur procesin e anëtarësimit dhe për të lobuar për t'u votuar nga PACE.

**"Epoka e re":** *Pra, Kosova nuk e ka shfrytëzuar sa duhet kohën kur Rusia ishte jashtë kësaj organizate?*

**Nurellari:** Përpara se të bëjmë atë që shqiptarët bëjnë më së miri, eksternalizimin e përgjegjësisë dhe mveshjen e fajeve të tjerëve pa pasur guximin që të bëjmë autokritikë, duhet parë me kurajë dhe sinqeritet se çfarë mund të kishim bërë ne më mirë. Fatkeqësisht, Kosova në vend se të angazhohej për t'u anëtarësuar në këtë organizatë, gjatë kësaj periudhe është fokusuar në problemet e brendshme dhe ka qenë e gozhduar nga një klimë e konfliktit të brendshëm që u karakterizua nga ngërçi, protestat për demarkacionin dhe asociacionin dhe u degradua në banalitetin dhe agresivitetin e gazit lotsjellës, molotovit, vezëve dhe makinave të ndezura ndaj oponentëve e deri te zola ndaj Kuvendit të Kosovës.

**"Epoka e re":** *Së fundi është bërë më mbizotërues mendimi se veçanërisht BE-ja po tregohet e padrejtë me Shqipërinë së cilës nuk po ia hap negociatat për anëtarësim dhe me Kosovën së cilës nuk po ia heq regjimin e vizave. Sa i bazuar është një mendim i tillë?*

**Nurellari:** Për hir të së vërtetës nuk mendoj se ka vend për një paralelizëm të saktë mes Shqipërisë dhe Kosovës. Për Shqipërinë, me pikëllim të thellë duhet të them se vështirë se e meriton hapjen e negociatave në kushtet aktuale të degradimit të situatës politike dhe vakuumit institucional ku mungojnë prej vitesh Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë, e ku opozita nuk është në parlament. Nga ana tjetër, Kosova i ka plotësuar tërësisht kushtet prej vitesh tashmë dhe nuk ka asnjë logjikë apo justifikim kjo vonesë e deritanishme. Megjithatë, duhet pasur parasysh që ne nuk kemi alternativë dhe e ka hapësirën e manovrës shumë të kufizuar në diplomaci. Nuk kemi, ta zëmë, luksin e Serbisë për ta kërcënuar Evropën me flirtim me Rusinë, sepse për ne lindja është vetëm kërcënim. Prandaj, përtej ankesës dhe qaramanisë, ne duhet ta mbledhim vetën e të mendojmë se çfarë të bëjmë me këto mundësi që kemi e të mos i dorëzohemi dëshpërimit dhe pasivitetit.



## Kuçi: Nëse opozita i bënë 61 vota, le ta rrëzojë qeverinë

**Prishtinë, 30 qershor** - Nëse Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje arrijnë t'i bëjnë 61 vota, le ta rrëzojnë qeverinë. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) është e gatshme të shkojë në zgjedhje. Kështu ka deklaruar deputeti i AAK-së, Blerim Kuçi, në një intervistë për "Kosovapress". Ai ka thënë se detyrë e opozitës është të ngrehë mocion atëherë kur i kanë votat.

Deputeti Kuçi ka vlerësuar se AAK-ja ka shënuar rritje të madhe në elektorat. Ai ka deklaruar se në të gjitha sondazhet që janë bërë kjo parti dhe lideri i saj kanë dalë në vendin e parë. Blerim Kuçi ka theksuar se nuk i kërkojnë zgjedhjet pasi kryeministri Haradinaj ka ende shumë punë për të bërë, por ka potencuar se AAK-ja ka shënuar rritje të jashtëzakonshme.

# Nga përdorimi i drogës vdiqën 97 qytetarë

Drejtori ekzekutiv dhe themelues i OJQ-së "Labyrinth", Safet Bakaj, ka treguar se që nga paslufta e deri më sot si pasojë e përdorimit të drogave kanë vdekur 97 qytetarë, kurse përdorues të rregullt të drogave janë 2 370 persona




**Prishtinë, 30 qershor** - Si pasojë e përdorimit të drogave që nga paslufta në Kosovë kanë vdekur 97 persona, kurse numri i përdoruesve të drogave ka arritur në 25 mijë. Përdorues të rregullt të drogave të regjistruar vetëm në OJQ "Labyrinth" janë 2 370. Këto të dhëna i ka bërë me dije për "EkonomiaOnline", Safet Bakaj, drejtor ekzekutiv dhe themelues i OJQ-së "Labyrinth", i cili ka treguar për numrin e rasteve të vdekjeve, për llojet më të shpeshta të drogave të përdorura në Kosovë si dhe për parandalimin e përdorimit të tyre. "97 persona kanë vdekur nga përdorimi i drogave. Këtë shifër e flas vetëm për personat që janë të regjistruar në databazën tonë. Ka qenë një shqetësim i madh në vitet 2009-2012, pasi ka pasur numër të madh të vdekshmërisë. Viti që më së shumti ka pasur vdekje ka qenë viti 2011 me 17 raste, në vitin 2016 kanë katër raste, në 2018 kanë qenë shtatë raste", ka thënë ai. Vitet në vijim, sipas Blakajt, do të jenë edhe më të vështirë, pasi do të fillojë përdorimi i drogave më të rrezikshme. "Rreziqet që na presin në tre vjetët apo pesë vjetët e ardhshëm janë drogat e reja që quhen 'New desing drogs', e që pritet të përdoren në Kosovë. Gjithashtu, edhe fenomeni i përdorimit të shumëfishtë të drogave, që janë posaçërisht të rrezikuar prej mbidozës, po ashtu edhe drogat që përdoren në psikiatri, paraqesin problem shumë", ka thënë Blakaj, duke shtuar se, sipas të dhënave që ka "Labyrinth", përdorues të rregullt të drogës janë diku 2 370 persona. Sipas tij, droga më e rrezikshme që shkakton varshmëri të fuqishme dhe të shpejtë është heroina. "Në vitin 2013 ka rënë dukshëm përdorimi i heroinës në Kosovë. Ky është lajm shumë i mirë, mirëpo është rritur përdorimi i marijuanës posaçërisht nga të rinjtë dhe fëmijët. Ndërsa droga e dytë më e përdorur është kokaina, e cila po përdoret shumë nga të rinjtë", ka theksuar Blakaj. Ai thotë se është shqetësues numri i përdoruesve të drogës nga gratë, posaçërisht i marijuanës dhe kokainës.

Blakaj ka treguar se në krahasim me vitet e mëhershme, tani grupmosha që e fillon përdorimin është 16.3 vjeç, kurse në vitet më herët ka qenë 21.4 vjeç. "Gjinia deri në vitin 2010-2011 ka qenë 7.6 për qind femërore, ndërsa në 2-3 vjetët e fundit është rritur përdorimi i drogave nga femrat, posaçërisht marijuana dhe kokaina. Vitin e kaluar mosha mesatare e personave që kanë filluar përdorimin e drogave ka qenë 16.2 vjeç. Ndërkaq, 10 vjet më përpara që ka qenë 21.4 vjeç. Pra, ka dallim të madh në moshë", ka thënë Blakaj.

# Certifikohen pjesëtarët e FSK-së të 'Njësisë për Siguri Fizike'



**Prishtinë, 30 qershor (ER)** - Në Brigadën e Reagimit të Shpejtë është mbajtur ceremonia e certifikimit të 198 pjesëtarëve të cilët kanë përfunduar me sukses trajnimin "Njësia për Siguri Fizike". Në këtë ceremoni të certifikimit morën pjesë ministri i Mbrojtjes, Rrustem Berisha, gjeneralmajor Gzim Hazrolli, gjeneralbrigade Fadil Hadergjonaj dhe komandantë të batalioneve të Brigadës të Reagimit të Shpejtë.

Ministri i Mbrojtjes, Rrustem Berisha, i ka uruar të certifikuarit për suksesin e treguar gjatë trajnimit, duke vlerësuar lart rëndësinë e kësaj njësie si komponentë e domosdoshme për rritjen në shkallë edhe më të lartë të sigurisë fizike të kazermave të FSK-së, pronës dhe objekteve të saj.

Gjeneralmajor Gzim Hazrolli në fjalimin e tij i ka uruar të gjithë pjesëmarrësit e këtij trajnimi për suksesin dhe rezultatin e arritur gjatë trajnimit, duke i uruar të gjithë të pranishmit, në veçanti BRSh-në, për punën profesionale dhe angazhimin e pakursyer gjatë këtij trajnimi.

Ndërkaq Fadil Hadergjonaj i ka përgëzuar instruktorët e trajnimit për angazhimin dhe realizimin e planit të trajnimit "Njësia për Siguri Fizike".

Ky trajnim ka filluar nga 10 qershori dhe ka përfunduar më 28 qershor.

Trajnimi është realizuar në dy faza pasi pjesëmarrësit në trajnim kanë qenë të ndarë në dy grupe.

## IKShPK-ja, thirrje qytetarëve: Kujdes ku po ushqeheni!

**Prishtinë, 30 qershor (ER)** - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) u ka bërë thirrje qytetarëve të vendit të kenë kujdes gjatë gatimit, ruajtjes dhe shpërndarjes së ushqimit. Siç njofton IKShPK-ja, çdo minutë sëmuren rreth 44 persona në botë dhe 23 milionë persona në vit nga ushqimi jo i sigurt dhe 4 700 persona në vit vdesin nga ushqimi jo i sigurt. "Jemi në sezonin e verës. Kujdes gjatë gatimit, ruajtjes dhe shpërndarjes së ushqimit. Mos hani ushqim kudo. Pakujdesia shkakton epidemi me rrezik për jetën e qytetarëve. Çdo minutë sëmuren 44 persona. Sot në botë sëmuren 23 milionë persona në vit nga ushqimi jo i sigurt dhe 4 700 persona në vit vdesin nga ushqimi jo i sigurt. Këto të dhëna të OBSh-së janë vetëm maja e ajsbergut. Të dhënat e sakta nuk dihen", është bërë me dije në njoftimin e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës.



Sot (e hënë) mbahet seanca e jashtëzakonshme për gjendjen në Luginën e Preshevës

# Kuvendi debaton për Luginën e Preshevës

Deputetët e Kuvendit të Kosovës sot (e hënë) në një seancë të jashtëzakonshëm do të debatojnë për gjendjen në Luginë të Preshevës. Përmes kësaj seance Kuvendi synon miratimin e një rezolute e cila do t'i adresojë kërkesat e shqiptarëve të Preshevës, Medvegjes dhe Bujanocit. Shqiptarët në Luginën e Preshevës thonë se janë komuniteti më i diskriminuar në Evropë, prandaj kërkojnë që çështja e Luginës të bëhet pjesë e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë



EPOKA E RE Faton DERMAKU

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Kuvendi i Republikës së Kosovës sot (e hënë) në orën 11:00 do të mbajë seancë të jashtëzakonshme për gjendjen në Luginën e Preshevës. Në këtë seancë, përveç debatit, deputetët synojnë të nxjerrin një rezolutë e cila do t'i adresojë kërkesat e shqiptarëve të Preshevës, Medvegjes dhe Bujanocit. Mbajtja e kësaj seance është iniciuar nga Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi si dhe Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media pas vizitës së disa deputetëve të Kuvendit të Kosovës në Luginë të Preshevës.

Kryetari i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi, Ismajl Kurteshi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se shqiptarët në Luginën e Preshevës janë komuniteti më i diskriminuar në Evropë. Ai ka deklaruar se çështja e Luginës duhet të bëhet pjesë e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Është e rëndësishme të ceket se shqiptarët në Luginë të Preshevës janë komuniteti më i diskriminuar në Evropë. Ndërsa askush prej Kosovës dhe prej Shqipërisë nuk e ngre këtë çështje në qarqet e BE-së. Serbia po përparon drejt integrimit në BE pa u vënë re se shteti serb po bën diskriminime që janë të paimagjinueshme se gjëra të tilla mund të ndodhin në Evropë", ka thënë Kurteshi.

Teksa ka folur për diskriminimin e shqiptarëve në Luginë, ai ka thënë se gjendja e atyre është më e rëndë se para katër vjetëve që ky komision kishte vizituar atë pjesë. Sipas tij, shqiptarët e asaj pjese duhet t'i gëzojnë të njëjtat të drejta që i gëzojnë serbët e Kosovës. "Kërkesa e shqiptarëve të Luginës së Preshevës drejtuar atij delegacioni shtetëror është që çështja e shqiptarëve të Luginës së Preshevës të bëhet pjesë e dialogut Kosovë - Serbi në Bruksel. Shqiptarët kërkojnë reciprocitet në të drejta. Pra, ato të drejta që i gëzojnë serbët në Kosovë duhet t'i gëzojnë edhe shqiptarët në Luginë. Kërkojnë që të zgjidhet çështja e teksteve shkollore dhe të ndodhë njohja e diplomave. Kërkojnë që në universitetet publike të Kosovës të ketë më shumë studentë nga Lugina", ka thënë ai.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje ka thënë se Lugina ka nevojë për mbështetje politike dhe materiale të Kosovës dhe Shqipërisë. "Natyrisht, kërkojnë që Kosova dhe Shqipëria të investojnë në projekte të ndryshme në komunat ku jetojnë shqiptarët sepse, siç thanë ata, nëse Serbia mund të investojë nga 500-600 milionë euro për serbët në Kosovë, atëherë Kosova dhe Shqipëria do të duhej të mbështesin shumë projekte në këto komuna", është shprehur Kurteshi, duke shtuar se tani është koha e fundit që Kosova dhe Shqipëria të bëjnë diçka për shqiptarët e asaj pjese.

# Ministrja Hoxhiq: Kriza humanitare në veri, lojë politike



PRISHTINË, 30 QERSHOR - Banorët serbë të katër komunave veriore ka disa ditë që kanë filluar "inskenimin" e një krize humanitare, sipas tyre, për shkak të taksës 100 për qind për prodhimet serbe të vendosura nga Qeveria e Kosovës.

Njëjtë nuk po mendon edhe ministrja e Administrimit të Pushtetit Lokal, Adrijana Hoxhiq, e cila një kohë të gjatë ka administruar zyrën në veri. Ajo në një intervistë për "EkonomiaOnline" pranon se në katër komunat veriore ka mungesë të disa artikujve ushqimorë dhe se raftet janë gjysmë të zbrazur, por krejt këtë e quan "lojë politike". "Për qytetarët nuk është e lehtë. Kriza humanitare është një lojë politike. Janë vendimet politike që po i bëjnë viktima vetë qytetarët. Unë mund të them se dje dhe sot raftet në dyqane të Mitrovicës Veriore kanë qenë gjysmë të zbrazura. Dyshoj se prapa kësaj janë politikat e larta", ka thënë Hoxhiq. Ajo ka shtuar se pas vendosjes së taksës në veri është krijuar një situatë e tensionuar dhe shpreson se Kosova dhe Serbia do të gjejnë një gjuhë të përbashkët për të tejkaluar këtë situatë.

Njohësi i çështjeve të sigurisë dhe ish-drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Behar Selimi, ka thënë për "Epokën e re" se skenari për improvizimin e krizës humanitare në veri është kërcënim për stabilitetin në vend. "Për sa kohë që Serbia, e përkrahur nga Rusia, manipulon politikanë lokalë serbë, pengon funksionimin normal të institucioneve tona shtetërore, lokale dhe qendrore, në veri dhe jo vetëm, konsideroj se siguria kombëtare është jostabile. Integriteti territorial është i mbrojtur si mos më mirë (KFOR-i është përgjegjës), por i kërcënuar vazhdon të mbetet ushtrimi i plotë i sovranitetit kudo dhe ndaj çdokujt brenda territorit tonë. Janë shumë shqetësues skenarët e fundit të improvizimit të krizave humanitare në veri të Mitrovicës dhe inkurajoj që sa më shumë të demaskohet çdo propagandë e tillë. Druaj se në këtë lojë është edhe e ashtuquajtura Qendra Ruso-serbe për Kriza Humanitare. Prandaj, skenari i krizës së improvizuar humanitare në veri është kërcënim për stabilitetin", ka thënë Selimi.

INTERVISTË ME DREJTORIN E KORPORATËS ENERGJETIKE TË KOSOVËS (KEK), NJAZI THAÇI

# Njazi Thaçi: Me gjithë vështirësitë, KEK-u po operon në kuadër të objektivave



Drejtori i Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), Njazi Thaçi, ka thënë se, pavarësisht prej sfidave me të cilat është duke u përballur kjo korporatë, janë duke operuar në kuadër të objektivave për nxjerrjen e thëngjillit dhe prodhimit të energjisë elektrike. Duke folur rreth protestës së punëtorëve të kësaj korporate, Thaçi ka thënë se në vazhdimësi ka përkrahur kërkesat e sindikatave, duke theksuar se do të plotësohen kërkesat aty ku ka mundësi. "Të gjithë jemi njëzëri se punëtori është aseti më i rëndësishëm i KEK-ut", ka thënë Thaçi

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 30 QERSHOR -

**"Epoka e re":** *Z. Thaçi, punëtorët e KEK-ut kanë protestuar këto ditë duke kërkuar dhënien e pagës jubilare në vazhdimësi, rivitalizimin e Termocentralit "Kosova A", rishikimin e Ligjit për paga dhe rritjen e shujtës së ushqimit. Cila është përgjigjja juaj ndaj këtyre kërkesave?*

**Thaçi:** Së pari më vjen mirë që jetojmë në një vend ku çdo pakënaqësi mund të shprehet në rrugë të ndryshme demokratike, pavarësisht nëse ajo pakënaqësi është e drejtë. Së dyti, ndihem mirë që si menaxhment, edhe përkundër vështirësive që kemi pasur, kemi bërë përpjekje të jemi të përkushtuar dhe që ta kemi në top prioritet punëtorin, duke i plotësuar kushtet e punës në aspektin e sigurisë dhe kujdesit. Korporata që drejtoj është shembulli më i mirë në vend duke përmbushur të gjitha obligimet ligjore sa iu përket të drejtave të punëtorëve si në aspektin e të hyrave të punëtorëve, sigurimin shëndetësor, shujtën, transportin, mjetet e sigurisë në punë dhe të gjitha obligimet ligjore. Sa iu përket kërkesave konkrete, në vazhdimësi i kemi përkrahur kërkesat e sindikatave, edhe tani jemi të gatshëm t'i plotësojmë ato kërkesa aty ku ka mundësi. Të gjithë jemi njëzëri se punëtori është aseti më i rëndësishëm i KEK-ut. Në vazhdimësi kam potencuar se falë përkushtimit të djersës së punëtorëve kemi arritur këto suksese duke e bërë KEK-un kompaninë me performancën më të mirë në vend, njëkohësisht duke qenë edhe kontribuuesi më i madh i shtetit. Do të vazhdoj të jem zëri i tyre për realizimin e çdo kërkesë legjitime e cila është brenda rregulloreve të KEK-ut, ligjeve dhe të drejtave tona. Ne duhet t'i shikojmë edhe mundësitë buxhetore, pra se sa rrezikon stabilitetin financiar të korporatës.

**"Epoka e re":** *Si është duke ecur procesi i prodhimit në KEK dhe a do të ketë reduktime të energjisë në sezonin veror?*

**Thaçi:** Sezoni veror është sezoni i vlugut të punëve përgatitore për sezonin e dimrit, njëkohësisht jemi duke realizuar obligimet tona në prodhim. Pavarësisht prej vështirësive të shumta të cilat janë të njohura, pra nga pjesa e shpronësimeve, pajisjeve të stërvjetruara dhe shumë problemeve të tjera që kishim vitin e kaluar, edhe në sezonin e dimrit por edhe tani kemi një performancë të shkëlqyer duke realizuar objektivat dhe duke tejkaluar ato në të gjitha drejtimet, edhe në pjesën e nxjerrjes së thëngjillit, ku i kemi tejkaluar parashikimet, po ashtu edhe në pjesën e prodhimit të energjisë elektrike. Gjithashtu, me kohë po realizohen të gjitha planifikimet edhe në remonte kapitale, edhe në pjesë të tjera.

**"Epoka e re":** *Pos këtyre që i cekët, cilat janë sfidat e tjera me të cilat përballeni si korporatë?*

**Thaçi:** Sfidat janë më të ndryshme. Nga vjetërsia e termocentraleve, ku disa prej tyre janë 60 vjet të vjetra, ndërsa e fundit që është instaluar ka 30 vjet prodhim. Sfidë në vetë janë mbajtja e tyre në prodhim për shkak se nuk kemi pasur mundësi të investojmë në kapacitetet e reja prodhuese. Përveç këtyre, sfidë tjetër tani kemi zgjerimin dhe hapjen e mihjes së re e cila ka kosto shumë të lartë dhe e cila planifikohet t'i furnizojë me thëngjill termocentralet për 40 vjetët e ardhshëm. Po ashtu, dhe rivitalizimi i "TC Kosova B" do të mundësonte një operim konform standardeve dhe direktivave të BE-së. Ka edhe shumë sfida të tjera por, falë përkushtimit dhe vullnetit të madh të menaxhmentit dhe të gjithë punëtorëve, besoj se do të realizohen dhe do të vazhdojmë të jemi shembulli më i mirë jo vetëm në Kosovë, por dhe më gjerë sa i përket zhvillimit të këtij sektori.

**"Epoka e re":** *Meqë jemi në prag të sezonit veror, çfarë bashkëpunimi do të ketë KEK-u me Korporatën Energjetike Shqiptare sa i përket sistemit hidro-termo?*

**Thaçi:** Bashkëpunimi i KEK-ut me Korporatën Energjetike Shqiptare gjatë gjithë këtyre viteve ka qenë i mirë. Vazhdojmë të kemi bashkëpunim vëllazëror sa i përket anës së respektit të ndërsjellë dhe shumë të favorshëm për gjithë qytetarët dhe korporatat në aspektin komercial. Po ashtu, me të gjitha kompanitë e tjera në regjion dhe më gjerë jemi të hapur të bashkëpunojmë. Konkretisht me Korporatën Energjetike Shqiptare kemi




marrëveshje për shkëmbim të energjisë elektrike dhe ajo është duke funksionuar siç është më së miri. Ky dhe është objektivi im.

**"Epoka e re":** *Po ashtu, është theksuar edhe planifikimi i investimeve të përbashkëta për krijimin e kapaciteteve të reja energjetike. A kemi ndonjë risi në këtë drejtim?*

**Thaçi:** Kemi dhënë disa propozime, duke përfshirë edhe investimet e përbashkëta në kapacitetet e reja energjetike. Mundësitë janë fantastike edhe si territore, por edhe të pasurive dhe mundësive që kemi në investimet në prodhim të energjisë nga thëngjilli në Kosovë dhe investimet në hidro në Shqipëri. Kjo do të na mundësonte që shkëmbimi i energjisë në sezone të ndryshime ta mbulojë gjithë konsumin në të dy shtetet. Duke qenë se jemi ndërmarrje publike dhe kemi kufizime, këto çështje duhet të kalojnë përmes aksionarit, gjegjësisht qeverisë.

**"Epoka e re":** *Bllokimi i linjës së interkonjeksionit 400 kilovoltë Kosovë - Shqipëri, çfarë pengesash është duke shkaktuar?*

**Thaçi:** Rrjetat e transmetimit apo bartjes menaxhohen nga një entitet tjetër publik KOSTT dhe nuk na takon neve që të flasim. Ne kemi inkurajuar dhe mbështesim aktivizimin e kësaj linje. Nëse kërkoni mendim timin personal, atëherë unë mund të them se është e pakuptimtë që të ndodhë kjo zvarritje, kur kjo do ta mundësonte rritjen e bashkëpunimit rajonal dhe përfitues do të ishin të gjitha vendet e rajonit.

# Miliardat e Kosovës në tregjet botërore

**Prishtinë, 30 qershor** - Më shumë se 2.5 miliardë euro ka arritur vlera e mjeteve të grumbulluara nga Trusti i Pensioneve dhe procesi i privatizimit, por paratë mbahen të ngrira në institucionet në tregjet e jashtme ndërkombëtare si dhe në ato financiare në Kosovë. Nga kjo shumë, mbi 1.8 miliard euro janë kursime të qytetarëve në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës. Përqindja më e madhe e këtyre mjeteve janë të investuara në tregjet e Gjermanisë, Japonisë, Anglisë, Francës dhe në tregjet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Kurse vetëm nga Fondi i Mirëbesimit nga privatizimi dhe likuidimi i ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë, deri në fund të muajit maj të këtij viti, Agjencia e Privatizimit ka arritur të grumbullojë më shumë se 730 milionë euro, të cilat janë të deponuara në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Nga Fondi i Mirëbesimit parashihet të kompensohen kredituesit potencialë të ndërmarrjeve shoqërore. Kurse në Buxhetin e Kosovës nga ky fond janë transferuar mbi 326 milionë euro, thuhet në një përgjigje nga zyrtarë të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Ekspertë për çështje ekonomike vazhdimisht kanë kërkuar kthimin e këtyre mjeteve në Kosovë dhe gjetjen e mënyrave për lejimin e qarkullimit të tyre. Ata thonë se Kosova vazhdimisht kërkon donacione dhe investime të huaja, kurse vetë institucionet e Kosovës mbajnë të ngrira mjete në tregjet financiare ndërkombëtare.

Profesori në Universitetin e Prishtinës, Mejdi Bektashi, thotë se qarkullimi i këtyre mjeteve në tregun e Kosovës duhet të realizohet me urgjencë, sidomos një pjesë e mjeteve të Trustit të Kursimeve. Ai thotë se me ndryshimin e bazës ligjore këto mjete mund të investohen sigurt në sektorë të cilët mund të ndikojnë në hapjen e vendeve të reja të punës. "Jam ithtar i asaj që ndryshimet ligjore të bëhen sa më shpejt. Jo ndoshta të gjitha, gjysma mund të mbesin në tregjet e huaja, por gjysma tjetër duhet të investohen në Republikën e Kosovës me vendime të organeve shtetërore, me qëllim që të rritet oferta e parasë në Republikën e Kosovës. Por, ashtu besoj se mundësitë e humbjes në tregun vendor janë shumë të vogla", ka thënë Bektashi.

Edhe eksperti për çështje ekonomike, Ismail Kastrati, njëherësh ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, thekson se një pjesë e këtyre mjeteve duhet të investohen për projekte kapitale. Ai përmend mundësinë e ndërtimit të termocentralit "Kosova e Re". "Kam qenë dhe jam ithtar i asaj që mjetet të kthehen në tregun e Kosovës. Jo të gjitha, por ato që mund të angazhohen në Kosovë. Ka mundur të ndërtohet termocentrali 'Kosova e Re' me mjetet e Fondit të Trustit, ku kthimi i mjeteve është i sigurt", thotë Kastrati për "Radion Evropa e Lirë|.

Fushë tjetër ku mund të investohen paratë e Fondit të Trustit dhe ato të Privatizimit, sipas ekspertëve, është sistemi bankar. Ky sistem, thotë Kastrati, vazhdimisht është treguar i qëndrueshëm. "Mund të plasohen në bankat komerciale të Kosovës, bankat pastaj mund t'i zbusin kamatat për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në vend. Ka shumë mundësi, por duhet të analizohet situata", shprehet Kastrati.

Edhe Bektashi thotë se futja në funksion e mjeteve të Trustit dhe Fondit të Mirëbesimit do të ndikojë edhe në uljen e kamatave për kredi në bankat komerciale në Kosovë. "Por, edhe përfitimi nga përdorimi i atyre mjeteve do të sjellin të ardhura dhe përfitime më të mëdha se në tregjet e jashtme. Por, automatikisht do të ndikonte edhe në uljen e interesit të normave të kamatave të kredive", ka theksuar Bektashi.

Zyrtarë të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Trustit të Kursimeve Pensionale tashmë kanë deklaruar se kthimi, apo vënia në qarkullim e këtyre mjeteve, nuk mund të bëhet për shkak të pengesave ligjore.



## Mbahet gara përkujtimore në peshkim "Jahir Mazreku"

MALISHEVË, 30 QERSHOR (ER) - Në brigjet e liqenit në Mirushë të Komunës së Malishevës, organizuar nga Shoqata e Peshkatarëve Sportivë "Sykuqi" në Malishevë, është mbajtur të dielën gara e parë përkujtimore në peshkim, e cila mban emrin e dëshmorit të kombit Jahir Mazreku.
Garuesit pjesëmarrës ishin nga të gjitha viset e Kosovës.
Kryetari i Shoqatës së Peshkatarëve Sportivë "Sykuqi" të Malishevës, Avdullah Paçarizi, i ka falënderuar të gjithë pjesëmarrësit në këtë garë përkujtimore e cila mban emrin e dëshmorit të kombit Jahir Mazreku.
Vendin e parë në këtë garë e zuri peshkatari Gazmend Krenzi, vendin e dytë Gëzim Çallaku dhe vendin e tretë Jeton Mazreku. Për të gjithë fituesit janë ndarë mirënjohje dhe çmime të siguruara nga Shoqata e Peshkatarëve Sportivë "Sykuqi".
Gara është mbikëqyrur nga referët e Federatës së Peshkimit të Kosovës.



# Komuna e Drenasit përfundon dhjetëra projekte infrastrukturore

DRENAS, 30 QERSHOR (ER) - Komuna e Drenasit ka përfunduar dhjetëra projekte infrastrukturore sipas planifikimit dhe është në përfundim të shumë projekteve të tjera. Në kohën kur kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka prezantuar në takimin me qytetarë për periudhën gjashtëmujore të punëve, ka përfunduar edhe rrjeti i kanalizimit në shumë fshatra në gjatësi të përgjithshme prej 26 280 metrash, asfaltim të rrugëve që janë në fazën e punimeve në gjatësi prej 25 mijë metrash, në rrugica me kubëza 457 metra, trotuare me gjatësi 680 metra, kanale atmosferike, kulluese, fazat për pastrimin dhe thellimin e lumit "Drenica" dhe "Verbica". "Komuna e Drenasit me intensitet është duke i implementuar projektet e planifikuara të kryhen gjatë këtij viti. Mjetet nga investimet kapitale të komunës janë rreth pesë milionë euro, ndërsa nga financimi i projekteve nga niveli qendror, garantet e ndryshme të performancës së mirë komunale si dhe përkrahja nga donatorët e ndryshëm, vlera e përgjithshme e investimeve për këtë vit kalon shumën mbi 10 milionë euro", ka njoftuar Komuna e Drenasit.



# Mbahet gara e diturisë në Skenderaj



SKENDERAJ, 30 QERSHOR (ER) - Në katër qendra të Komunës së Skenderajt është realizuar gara e diturisë në nivel komunal. Në këtë garë kanë marrë pjesë rreth 500 nxënës nga të gjitha shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta të kësaj komune.
Drejtoria Komunale e Arsimit ka bërë organizimin e këtyre garave dhe është kujdesur që procesi i garimit të jetë korrekt.
Drejtori i kësaj drejtorie, Bekim Latifi, e ka përcjellë nga afër procesin e garimit të nxënësve. Ai në emër të kryetarit të Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, i ka përshëndetur dhe falënderuar nxënësit, administruesit, kujdestarët e nxënësve garues për mbarëvajtjen e kësaj gare nacionale të diturisë si dhe ka kërkuar nga nxënësit të jenë më këmbëngulës në kërkim të dijes.
Qëllimi i kësaj gare diturie është që nëpërmjet këtij vlerësimi të zbulohen talentët dhe të investohet në talentin e tyre, orientimi i nxënësve në profesionin e dëshiruar si dhe garimi ndërmjet moshatarëve.
Fituesit e gjeneratës për secilën lëndë do të garojnë në nivelin republikan.

# Haziri uron Kosumin për rizgjedhjen rektor i Universitetit 'Kadri Zeka'

Haziri i ka uruar suksese Kosumit në pozitën rektorit, duke theksuar se shpreson që të bëhet realitet kompleksi i këtij universiteti. "I uroj suksese në pozitën e rektorit ish-kryeministrit të Kosovës dhe mikut tim Bajram Kosumi

GJILAN, 30 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i ka dërguar një telegram urimi Bajram Kosumit për rizgjedhjen në pozitën e rektorit të Universitetit të Gjilanit "Kadri Zeka".
Haziri i ka uruar suksese Kosumit në pozitën rektorit, duke theksuar se shpreson që të bëhet realitet kompleksi i këtij universiteti. "I uroj suksese në pozitën e rektorit ish-kryeministrit të Kosovës dhe mikut tim Bajram Kosumi. Besoj dhe shpresoj shumë që kompleksin universitar me standardet më të larta ta bëjmë realitet, i cili do të shërbejë jo vetëm për qytetarët e Gjilanit dhe të Anamoravës, por edhe për ata të Kosovës Lindore", ka thënë Haziri në urimin e tij.
Bajram Kosumi është rizgjedhur javën e kaluar rektor i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan.



# Mbi 20 mijë tonë barna pa afat mbahen në depo

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Më shumë se 20 mijë tonë barna pa afat, të cilat janë jashtë përdorimit, qëndrojnë nëpër depo të ndryshme në Kosovë. Kjo përllogaritje është bërë në bazë të një punimi ndërkombëtar në vitin 2018. Prej atëherë nuk është asgjësuar asnjë ilaç, kështu që tani besohet se sasia është edhe më e madhe.

Një sasi kaq e madhe e barnave pa afat nëpër depo rrezikon drejtpërdrejt shëndetin e qytetarëve.

Kryeinspektori i Inspektoratit Farmaceutik të Ministrisë së Shëndetësisë, Shaban Osmanaj, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se mosasgjësimi i barnave pa afat lidhet me paqartësitë që kanë të bëjnë me çështjet ligjore për asgjësim. Ai thotë se bëhet fjalë për barna të cilat lirojnë gazra dhe rrezikojnë ambientin, barna shpuese që rrezikojnë punëtorët që merren me to si dhe barna të cilat hidhen në vende joadekuate e që rrezikohet uji. "Sigurisht se mosasgjësimi i barnave është shumë i rrezikshëm për shëndetin e qytetarëve. Prej pasluftës ka barna që nuk janë asgjësuar dhe rrinë nëpër depo. Një aksion është ndërmarrë në vitin 2008 prej Ministrisë së Shëndetësisë dhe asgjësimi ka qenë i paqartë dhe është ndërprerë. Asgjësimi i barnave nuk është i kundërligjshëm, por nuk është i qartë, pasi rregullohet me tre ligje. Ligji për shëndetësi, ai për produkte dhe pajisje mjekësore dhe Ligji për mbeturina. Shikuar nga ky këndvështrim, është kërkuar të bëhet ndryshimi i ligjit aktual dhe është krijuar grupi për konceptdokumentin për mbeturina, i cili është në fazën përfundimtare. Pa u rregulluar çështja ligjore këto barna nuk mund të asgjësohen", ka thënë Osmanaj.




Vetëm në depot e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Agjencisë për Produkte dhe Pajisje Mjekësore llogaritet se ka deri në 8 tonë barna pa afat, gjithashtu barna ka edhe në depon qendrore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe në qendrat e mjekësisë familjare. Së fundmi, edhe në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës është evidentuar një sasi e konsiderueshme barnave me afat të skaduar, të cilat, sipas Shpend Fazliut, zëdhënës i këtij institucioni, tashmë janë izoluar dhe, siç thotë ai, nuk paraqesin rrezik për jetën e njeriut.

Megjithatë, ai thotë se po presin që të asgjësohen këto barna, pasi nuk janë të vetmet pa afat që qëndrojnë në këtë depo. "Në Barnatoren Qendrore të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës është evidentuar një sasi e barnave pa afat dhe ato janë izoluar. Që të gjitha janë regjistruar nga komisionet e veçanta, në kuadër të Barnatores Qendrore dhe për të gjitha i është raportuar Inspektoratit Farmaceutik që vepron në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë. Në momentin që Ministria e Shëndetësisë kontrakton një kompani, do të fillojë asgjësimi i barnave. Këto barna janë të izoluara dhe nuk rrezikojnë shëndetin e qytetarëve apo pacientit. Është një sasi e barnave të grumbulluara edhe më herët. Të gjitha janë të raportuara", ka thënë Fazliu.

Sidoqoftë, në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor patën thënë se çështja e asgjësimit të barnave është rregulluar me një akt nënligjor, përkatësisht me një udhëzim administrativ, i cili në hollësi i përcakton kushtet me të cilat bëhet asgjësimi i barnave në Kosovë. "Kjo gjë mund të bëhet në institucionet e licencuara për këtë çështje dhe në bazë të kontratave të veçanta të institucioneve shëndetësore, lidhen edhe kontrata të veçanta. Udhëzimi administrativ e parasheh edhe shkatërrimin e barnave në 'Sharrcem', 'Ferronikel' apo në Korporatën Energjetike të Kosovës, ku krijohen temperatura të larta, të cilat e mundësojnë shkatërrimin pa pasoja për mjedisin. Por, të gjitha këto duhen rregulluar me kontrata të veçanta", patën thënë zyrtarë në këtë ministri. Megjithëkëtë, Ministria e Shëndetësisë ende nuk ka bërë kontratë me ndonjë kompani për asgjësimin e barnave, ndonëse thuhet se janë grumbulluar mbi 20 mijë tonë barna pa afat.

# Në Mitrovicë hapet pishina 'Aqua Parku'



MITROVICË, 30 QERSHOR (ER) - Para dy ditësh në qytetin e Mitrovicës është hapur parku ujor "Aqua Park" afër Liqenit Akumulues, i cili është më i madhi në vend dhe në rajon. Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se ky projekt madhor i realizuar buzë Ibrit është një nga destinacionet më atraktive të vendit. Ai ka thënë se hapësira përgjatë Ibrit do të jetë më e rregulluara në Ballkan. "Ky projekt madhor i realizuar buzë Ibrit është një nga destinacionet më atraktive të vendit, ndërsa hapësira përgjatë Ibrit do të jetë hapësira më e rregulluar në Ballkan. Mitrovicasit më nuk do të shkojnë nëpër komuna të tjera të vendit për t'u freskuar në pishinat e atjeshme. Ata do t'i kenë këtu pishinat më bashkëkohore, të mbyllura dhe të hapura, olimpike dhe gjysmolimpike. Tash e tutje qytetarët e komunave të tjera do të vijnë në Mitrovicë për t'i shijuar bukuritë përgjatë lumit Ibër", ka thënë kryetari Bahtiri.

Kjo pishinë ka një sipërfaqe rreth 2 000 metra katrorë, lumin "dembel" me një gjatësi prej 300 metrash etj. Për realizimin e këtij projekti janë investuar mbi 7 milionë euro nga Sh. A. "ACI", që është themeluar nga "Arjeta Group" dhe "Linprojekt", të dyja kompani vendore, ndërsa Komuna e Mitrovicës e ka mbështetur projektin me ndarjen në shfrytëzim të hapësirës komunale.

# Ka filluar realizimi i projektit për rregullimin e ndriçimit publik në 18 vendbanime të Malishevës

MALISHEVË, 30 QERSHOR (ER) - Në kuadër të realizimit të projekteve kapitale në Komunën e Malishevës këto ditë ka filluar edhe realizimi i njërit prej projekteve të mëdha, përkatësisht rregullimi i ndriçimit publik në 18 vendbanime të Komunës së Malishevës, ku përfshihet qyteti në tërësi dhe 17 fshatra, me gjithsejtë 32 rrugë apo lagje.

Realizimin e këtij projekti e kanë inspektuar nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha dhe drejtori për Buxhet, Valon Hoti, të cilët janë ndarë të kënaqur me punimet e kryera deri më tani. "Ne po punojmë intensivisht për realizimin e projekteve të parapara për këtë vit. Në mesin e shumë projekteve dhe investimeve, është edhe rregullimi i ndriçimit publik, i cili është i paraparë të rregullohet në disa pjesë të komunës sonë. Ndriçimi publik ka rëndësi të shumëfishtë, duke filluar nga siguria që krijohet, po ashtu edhe lëvizja më e lehtë e qytetarëve, por edhe ngasësve të automjeteve, sidomos në vendbanime. Projekti i rregullimit të ndriçimit publik është duke u realizuar sipas dinamikës së paraparë dhe besoj se brenda pak ditëve të gjithë këta fshatra apo rrugë do të jenë të ndriçuara", tha nënkryetari Berisha.

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Valon Mazreku, ka bërë me dije se realizimi i këtij projekti mundësohet nga buxheti Komunës së Malishevës dhe ky projekt është i paraparë në listën e investimeve në projektet kapitale.



## Weberi heq dorë nga drejtimi i Komisionit Evropian



BRUKSEL, 30 QERSHOR - Konservatori gjerman Manfred Weber hoqi dorë nga drejtimi i Komisionit Evropian me kusht që të jetë president i Parlamentit Evropian, sipas burimeve nga brenda PPE-së në ditën e mbledhjes së jashtëzakonshme të Këshillit Evropian në Bruksel.
Weber, "Spitzenkandidat" (Kandidati kryesor) i konservatorëve, u takua në javët e fundit me presidentin francez Emmanuel Macron, që ka qenë edhe një prej zërave më të fuqishëm kundër atij.
Shkëmbimi i mundshëm mes familjeve politike që do të krijojnë mazhorancën në Parlamentin Evropian të ri parashikon që socialisti holandez Frans Timmermans të jetë në krye të Komisionit, ndërsa Weber në krye të Parlamentit në Strasburg.
Marrëveshja, e mbështetur nga kancelarja gjermane Angela Merkel, do të plotësohet me kryeministrin liberal belg Charles Michel në drejtimin e Këshillit të BE-së dhe konservatorja Kristalina Georgieva si pasuese të Mogherini në Politikën e Jashtme dhe të Mbrojtjes së Përbashkët.
Parisit do t'i jepet presidenca e BQE-së, ku do të zgjidhet guvernatori i Bankës së Francës, Villeroy de Galhau. Megjithatë, ky kuadër ka shumë të panjohura, duke filluar nga kundërshtimi i vendeve të grupit të Vishegradit (Hungari, Poloni, Sllovaki, Republikë Çeke) ndaj emërimit të Timmermans, të cilëve iu shtohet edhe mbështetja e Italisë e shpallur nga Matteo Salvini.
Ndërsa presidenti i Fancës, Emmanuel Macron, kërkoi të dielën sërish që të emërohen dy gra dhe dy burra si dhe të ketë një ekuilibër gjeografik për postet kryesore të pushtetit të Bashkimit Evropian. "Ka katër poste të pushtetit nën përgjegjësinë tonë. Për mua, duhen dy gra dhe dy burra dhe duhet që të ketë edhe personalitete nga Evropa Lindore", njoftoi ai pasi mbërriti në Bruksel për një mbledhje të jashtëzakonshme të Këshillit Evropian për këto emërime.

# Trumpi, presidenti i parë i ShBA-së që shkel në Korenë e Veriut

Donald Trumpi shkroi një rast në histori. Ai u bë presidenti i parë në historinë e ShBA-së që shkeli në territorin e Koresë së Veriut komuniste, ku së bashku me pushtetmbajtësin Kim Jong Un kaluan drejt Veriut në zonën e çmilitarizuar



UASHINGTON, 30 QERSHOR - Presidenti i ShBA-së, Donald Trump dhe kryetari i Koresë së Veriut, Kim Jong Un, u takuan në kufirin midis Koresë së Veriut dhe asaj të Jugut. Trumpi është presidenti i parë në detyrë i ShBA-së që hyri në tokën e Koresë së Veriut komuniste. Vijën e demarkacionit ai e kaloi në vendin e quajtur Panmunjom. "Jam krenar që e kam kaluar këtë vijë", tha presidenti Trump. Pastaj, së bashku me Kimin ai kaloi në territorin e Koresë së Jugut, ku u takuan me presidentin Moon Jae In, ku pasoi një bisedë me dyer të mbyllura, ka njoftuar "DW".
Trumpi dhe Kimi u morën vesh t'i rinisin bisedimet mes dy vendeve. Në javët e ardhshme do të ngrihen grupe pune në të dyja anët. Grupin e ShBA-së do ta krijojë sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo. Shtetet e Bashkuara të Amerikës kërkojnë çarmatimin e plotë bërthamor të Koresë së Veriut. Përveç kësaj, ShBA-ja dhe Koreja e Jugut synojnë të arrijnë një marrëveshje zyrtare për paqen në Kore. Trumpi nuk bëri të ditur se për çfarë hollësish duhet të flasë fillimisht grupi i punës. Ai bëri të qartë se sanksionet e gjera kundër Koresë së Veriut mbeten në fuqi. Veç kësaj, në takimin në Panmunjom ai e ftoi në Uashington pushtetmbajtësin e shtetit komunist.
Trumpi theksoi në mënyrë të përsëritur marrëdhënien e tij personale të mirë me Kimin. "E pëlqyem njëri-tjetrin që ditën e parë", tha presidenti amerikan. Kimi, gjithashtu, e përshkroi "të shkëlqyer" marrëdhënien e tij personale me Trumpin. Në përshëndetje, ai i tha presidentit amerikan se gëzohet që e takon përsëri. Ai nuk e kishte pritur që ta takonte ndonjëherë në këtë vend. Shtrëngimi i duarve ka "rëndësi të madhe për paqen", tha Kimi më tej. "Ne do ta lëmë pas të kaluarën dhe do të shkojmë drejt së ardhmes", theksoi ai dhe e përshkroi iniciativën e Trumpit për takimin si një "veprim shumë të guximshëm". Ky ishte takimi i tretë i dy politikanëve. Në samitin e parë të Trumpit dhe Kimit në Singapor në qershor 2018, Koreja e Veriut në parim ra dakord për çarmatimin bërthamor. Por atëherë nuk u ra dakord për hapa konkretë. Një takim i dytë në Hanoi në shkurt dështoi sepse nuk kishte asnjë lloj afrimi. Që atëherë, bisedimet bërthamore midis Uashingtonit dhe Phenianit kanë ngecur. ShBA-ja kërkon nga Koreja e Veriut të heqë dorë nga armët bërthamore, kurse Koreja e Veriut dëshiron heqjen e sanksioneve. Vetëm pak ditë më parë udhëheqja e Phenianit kishte kërkuar më shumë vullnet të mirë nga Shtetet e Bashkuara.

## Erdogani i bindur se ShBA-ja nuk do të vendosë sanksione ndaj Turqisë

ANKARA, 30 QERSHOR - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ka thënë se është i sigurt se Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) nuk do të vendosin sanksione ndaj shtetit të tij, pasi Ankaraja insiston që të mos e anulojë marrëveshjen për blerjen e sistemeve të mbrojtjes raketore "S-400" nga Rusia.
Erdogani është takuar në margjinat e samitit të G20-s me presidentin e ShBA-së, Donald Trump, me të cilin kanë biseduar për marrëveshjen e Turqisë me Rusinë për blerjen e sistemeve "S-400". "Dëgjuam nga Trumpi se nuk do të ketë diçka të tillë (sanksione)", ka thënë Erdogani. Ai ka insistuar se Turqia dhe ShBA-ja janë partnerë strategjikë dhe ka shtuar se "askush nuk ka fuqi që të ndërhyjë në sovranitetin e Turqisë".
Kabineti i Erdoganit përmes një deklarate ka thënë se presidenti Trump ka shprehur dëshirën e tij që çështja e sistemit "S-400" të mund të "zgjidhet pa prishur marrëdhëniet bilaterale" ShBA - Turqi, raporton "AFP".
Pavarësisht prej presionit nga Uashingtoni që marrëveshja për blerjen e këtij sistemi të mbrojtjes raketore të anulohet, Erdogani vazhdimisht ka deklaruar se kjo nuk do të ndodhë dhe së fundmi ka thënë se dërgesa e parë e sistemeve ruse do të arrijë në Turqi në mesin e muajit korrik.




Shijo
Pranverën
me...
Jaffa
Champion
PLUS
A+C+E
Multifrutti
Taste of World Wide Brand!
2L
Jaffa
Champion


AUTOSHKOLLA
“RITMO – L”
Auto Shkolla
“RITMO - L”
Prishtinë
Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.
Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333

E jashtëzakonshme

## Gjendet kandili vdekjeprurës në bregdetin e Marbellas



Një kandil deti vdekjeprurës është parë në bregdetin e Marbellas në Spanjë. Këto lloj speciesh shkaktojnë dhimbje shumë të mëdha, madje dhe vdekjen e njeriut. Kjo krijesë vdekjeprurëse është parë dhe fotografuar nga fotografi Daniel Blanco, ndërkohë që po lundronte pranë qytetit "Costa del Sol". Krijesa helmuese ndodhej vetëm pak metra larg një grupi fëmijësh, të cilët po luanin me njëri-tjetrin. Nuk ka asnjë raport për të prekur apo viktima në këto brigje.

FOTO E DITES




Një fëmijë shihet në një rrugë të përmbytur në Anama, në shtetin Amazonas të Brazilit. /Reuters/

E rrallë

## Dorëheqja më e pazakontë, letër pronarit: Më vjen keq për humbjen tuaj




Dorëheqja nga puna është gjithmonë e vështirë, pavarësisht nëse punoni në një vend të mirë apo të keq. Ekzistojnë shumë mënyra që ta bëni një situatë më pak të sikletshme dhe një djalë e ka vërtetuar këtë. Ai i ka shkruar pronarit të tij një letër ku i thoshte se do të përballej me humbje të madhe. Sam Baines, 22-vjeçar nga Sheffield, ia ka shkruar kështu këtë letër shefit të vet: "Më vjen keq për humbjen tuaj. Dita ime e fundit e punës është 29 korriku. Mendoj se kjo do të jetë një periudhë e vështirë për ty".

## BARSOLETA E DITËS



**Një burrë dhe grua shkojnë në operë. Pas një gjysmë ore që kishte filluar shfaqja, gruaja i thotë burrit:**
**- Shiko atë burrin në krahun tënd si e paska zënë gjumi.**
**Burri: Për të më treguar budallallëqe më zgjon nga gjumi ti mua?**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)**

### "THE SECRET LIFE OF PETS 2" 3D




I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min

**Rolet:** Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan

**Regjia:** Chris Renaud and Jonathan Del Val




**Ne ora 18:00**

### "X-Men; Dark Phoenix"

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min

**Rolet:** James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain

**Regjia:** Simon Kinberg

**Në ora 20:00**

### "MEN IN BLACK; INTERNATIONAL" 3D,




Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

**Rolet:** Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson

**Regjia:** F. Gary Gray




**Ne ora 22:00**

### "M A"

Horror/Triller; 1 ore 39 min

**Rolet:** Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown

**Regjia:** Tate Taylor

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Dashuria do të zërë një vend të rëndësishëm gjatë ditës. Shumë vendime të shtyra sot do të marrin formë përfundimtare.



**DEMI**
Arsyeja dhe logjika nuk ju lënë të merrni asnjë hap të guximshëm dhe të rrezikshëm në të njëjtën kohë. Keni nevojë për adrenalinë.



**BINJAKËT**
Po shijoni shumë atë ç'ka ju ofron dita pa kërkuar asgjë më tepër. Lumturia bëhet nga çastet e vogla.



**GAFORRJA**
Sot do të flisni për financa dhe për biznes që në orët e para të ditës. Nëse janë veç fjalë dhe nuk do të kaloni në veprime konkrete, nuk presin punët.



**LUANI**
Loja që po luani me një person të caktuar do të rezultojë e rrezikshme. Disa nga pasojat s'i kishit menduar fare.



**VIRGJËRESHA**
Një çështje financiare ju ka shqetësuar më shumë sesa që mendonit. Keni humbur fokusin dhe nga gjërat e rëndësishme.



**PESHORJA**
Keni dëshirë veç për udhëtime këtë periudhë. Koha dhe ritmi juaj e favorizojnë së tepërmi këtë dëshirë.



**AKREPI**
Jeni në mëdyshje të pranoni ose jo një marrëveshje të minutës së fundit. Mos u mendoni shumë sepse do të keni shumë favore.



**SHIGJETARI**
Partneri është bërë shumë kërkues karshi jush. Ka filluar t'ju bezdisë disi ky fakt.



**BRICJAPI**
Mos prisni që dita e sotme të ketë zhvillime për t'u mbajtur mend. Do të kalojë pa ndonjë situatë të rëndësishme.



**UJORI**
Keni filluar të ndryshoni mendim për një situatë të shërbyer nga të tjerët. Tani që po e përjetoni drejtpërdrejt, ju duket krejt ndryshe.



**PESHQIT**
Po bëheni gati të ndërmerrni një hap të rëndësishëm, po më parë doni të konsultoheni me ata që ju japin gjithmonë këshilla të vlefshme.

# Justin Bieber emocionon me fjalët për gruan



Justin Bieber ka postuar një fotografi me bashkëshorten Hailey Bieber, të realizuar në shkretëtirë. Këngëtari 25-vjeçar ka shtuar një mesazh të ëmbël nën imazh duke deklaruar sërish dashurinë e tij për gruan. "Këto janë çastet për të cilat jetoj. Vetëm koha me ty ma freskon shpirtin. Ti je e imja dhe unë jam i yti", ka shkruar Justin në "Instagram", duke shtuar me hashtag 'përgjithmonë dhe gjithmonë'. Kendall Jenner komentoi më pas duke thënë 'ajo është edhe pak e imja'.

# Katharine McPhee, një nuse e përrallave



Katharine McPhee dukej tamam si princeshë në ditën e dasmës së saj. Sot ylli i "American Idol" e ka kurorëzuar dashurinë me producentin muzikor, 69-vjeçarin David Foster në Londër. Në ditën e saj më të rëndësishme, McPhee ka zgjedhur ta veshë një fustan të bardhë të dizajnuar nga disenjatori amerikan Zac Posen.



# Demi Lovato bëhet me tatuazh të ri

Këngëtarja e njohur Demi Lovato ka realizuar një tatuazh të ri. Këtë e ka bërë me dije vetë këngëtarja me anë të publikimit të një fotografie në rrjete sociale. Lovato e ka falënderuar artistin që i krijoi këtë tatuazh, duke thënë se të gjithë duhet ta vlerësojnë veten. "Nuk mundeni ta dashuroni askënd derisa ju nuk e dashuroni së pari veten tuaj", ka thënë Lovato duke treguar kuptimin e këtij tatuazhi.



# Bradley Cooper dhe Lady Gaga së bashku në një projekt të ri kinematografik



U përfol shumë për një lidhje të mundshme mes tyre, që pas xhirimeve të filmit "A Star Is Born". Bëhet fjalë për Bradley Cooper dhe Lady Gaga. Miqësimi i tepërt gjatë filmit, pas tij dhe marrëdhënia shumë e mirë që kishin së bashku, bëri që aktori të ndahej nga modeluesja Irina Shayk. Sipas lajmeve të shoubizit, dyshen do ta shikojmë përsëri në një projekt kinematografik. Sipas mediave të huaja, Cooper dhe Gaga do të jenë pjesë e kastit të prodhimit kinematografik 'Guardians Of The Galaxy 3'.

# Mit'hat Frashëri u emocionua shumë gjatë vizitës së shkollave për vajza të aleancës izraelite

Nga Aurenc BEBJA*,
*Francë – 29 Qershor 2019*

"Journal de Salonique" ka botuar, të hënën e 4 shkurtit 1907, në ballinë, një shkrim në lidhje me vizitën e Mit'hat Frashërit në shkollat për vajza të Aleancës Izraelite, të cilin, Aurenc Bebja, nëpërmjet Blogut "Dars (Klos), Mat – Albania", e ka sjellë për publikun shqiptar:

"I nderuari Mit'hat Bej, drejtor i Çështjeve Politike të vilajetit tonë, i shoqëruar nga z. Eduard Abravanel (Pronar – Farmacist i njohur), vizitoi të enjten shkollat e vajzave të Aleancës Izraelite dhe Sallën e Azilit. Vizitorët gjithashtu morën pjesë në drekën që Aleanca u mundëson nxënësve të varfër. Mit'hat Bej uroi ngrohtësisht drejtoreshat dhe mësimdhënësit e Shkollave të vajzave. Ai na siguroi se mori përshtypjen më të mirë të këtyre shkollave që po përparojnë në mënyrë të shkëlqyeshme. Shikimi i nxënësve të varfër që po drekonin në tryezën e shkollës e bënë atë të ndihej shumë i emocionuar."





Visite scolaire. — L'honorable Midhat bey, directeur des Affaires Politiques de notre velayet, accompagné de M. Edouard Abravanel, a visité jeudi les écoles des filles de l'Alliance Israélite ainsi que la Salle d'Asile. Les visiteurs ont également assisté au repas que l'œuvre de nourriture de l'Alliance donne aux élèves pauvres.

Midhat bey a félicité chaudement les directrices et le personnel enseignant des Ecoles de filles. Il nous assure qu'il a emporté la meilleure impression de ces établissements scolaires qui progressent d'un façon admirable.

La vue des élèves pauvres déjeunant à la table de l'école l'a vivement émotionné.

# Si u qëllua Ahmeti Zogu, 3 herë me revolver nga studenti

Nga Aurenc BEBJA*,
*Francë – 28 Qershor 2019*

"Le Figaro" ka botuar, të dielën e 24 shkurtit 1924, në faqen n°3, një shkrim në lidhje me atentatin ndaj Ahmet Zogut, asokohe kryeministër i Shqipërisë, të cilin, Aurenc Bebja, nëpërmjet Blogut "Dars (Klos), Mat – Albania", e ka sjellë për publikun shqiptar :

**ROMË, 23 SHKURT.**
Na shkruajnë nga Tirana, më 23 shkurt, nëpërmjet Agjencisë Stefani :
"Në momentin kur Kryeministri shqiptar, z. Zogu, hyri në sallën e Asamblesë Kushtetuese, një student me emrin Beqir Valteri, qëlloi tri herë me revolver mbi të, duke i shkaktuar plagë të lehta në dorë dhe në këmbë.
Nuk ka asnjë shqetësim për gjendjen e z. Zogu.
Fajtori u arrestua dhe u dorëzua para drejtësisë.
Qetësia mbretëron kudo.
Asambleja vazhdoi punën e saj.
Z. Frashëri u zgjodh President."



# Kurani më i vogël në botë mbahet nga një laçjan. Ja kush është ai



Faqja e njohur "Wetbookclub" ka publikuar ditën e sotme si foton e saj të ditës, një imazh ku shfaqet një Kuran shumë i vogël i mbajtur nga një familje shqiptare.
Sipas shkrimit krahas fotos thuhet se Libri i shenjtë që ka qenë në familjen Prushi prej gjeneratash dhe është nxjerrë në shitje.
Kurani me përmasa 26.8 mm i gjatë dhe 21.6mm i gjerë mbahet në dorë në këtë foto nga shqiptari Skënder Halim Prushi. Libri i shenjtë, i cili peshon 5.2 gram ndodhet në veri të Shqipërisë në Laç dhe foto e publikuar ditën e sotme daton që në 15 nëntor të vitit 2006

# Befasuese, në Mars zbulohen mijëra vullkane prej balte

Në Mars është një zonë prej 12 000 kilometrash katrorë e mbushur me mijëra vullkane prej balte, pra struktura të krijuara nga ngritja e ujit nga thellësia, sedimenteve dhe gazit dhe jo nga dalja e llavës.
Të zbuluara nga një kërkim italian, i kryer nga Universiteti i Padovas dhe të përshkruar në revistën "Scientific Reports", vullkanet janë të hershëm dhe hapin skenarë të rinj në lidhje me praninë e ujit në nëntokën e planetit të kuq.
Krijimi i vullkaneve të baltës ka ndodhur rreth 370 milionë vite më parë, në një epokë shumë të hershme për kohën gjeologjike marsiane dhe ky zbulim është mjaftueshëm për të vënë në dyshim shumë njohuri mbi planetin e kuq.
"Ky është një zbulim që vë në dyshim aktivitetin e planetit dhe hap një kapitull të ri pyetjesh në lidhje me sasinë e ujit që ka mbetur e bllokuar në thellësi të planetit", thekson Barbara De Toffoli, e departamentit të Gjeoshkencave.
Nga ky studim dalin të dhëna që ndihmojnë në kuptimin e evolucionit të planetit dhe proceset që e kanë formësuar atë.



# Ky planet po shkatërrohet
## Fotoja që i tronditi të gjithë







Një foto e postuar nga "Mirror" tregon një zog në një plazh në Florida teksa I jep të voglit të tij një bisht cigareje, duke menduar se është ushqim. I vogli e mori bishtin e cigares dhe ishte gati ta gëlltiste.
Fotot, të cilat janë një kambanë alarmi për ndotjen, janë shkrepur nga Karen Catbird e cila i shpërndau më pas edhe në Facebook. Bashkë me foton ajo shkruante:
"Nëse pini cigare, ju lutem mos i hidhni në tokë bishtat. Edhe unë vetë tymos por nuk i hedh kurrë bishtat në tokë, thjesht një gjë e shpifur që i bëjmë jetës së egër."

# Mjafton një llambë LED, ja si do të bëhet lidhja me internet në të ardhmen

Në të ardhmen do të mjaftojë thjesht një llambë LED për të qenë gjithnjë të lidhur në internet me kompjuterin, tabletën dhe smartfonin, ky është revolucioni i "Li-Fi", një "Wi-Fi" prej drite që do të mundësojë transmetimin e shpejtë të sasive të mëdha të të dhënave duke garantuar një mbrojtje më të madhe të komunikimit.
"Ndërsa Wi-Fi përdor valët radio, Li-Fi përdor ato elektromagnetike", shpjegon Michele D'Amico doktor i "Wireless and Mobile Propagation" në Politeknikun e Milanos.
Për të krijuar lidhjen në internet do të mjaftojë vetëm një llambë LED me ndriçim normal.
Drita e dukshme e ndryshuar në shpejtësi të lartë transmeton të dhëna drejt pajisjes së përdoruesit, kompjuter apo smartfon, që duhet të jetë i pajisur me një aparaturë që transformon ndryshueshmërinë e ndriçimit të LED në sinjale elektrike.
"Mes pikave të forta të Li-Fi është rrezja optike, që garanton mbrojtjen e ndërhyrjeve nga sistemet e tjera dhe një mbrojtje më të lartë nga përgjimet. Për më tepër, meqenëse nuk përdor frekuencat radio, Li-Fi mund të përdoret në avionë dhe spitale", thekson eksperti i Politeknikut.
"Megjithatë kjo teknologji e re



ka edhe limite. Li-Fi nuk tejkalon pengesat si muret për pasojë duhet të instalohet një pajisje në çdo ambient ku dëshiron të lidhesh në internet. Për më tepër duhet që dritat të mbeten gjithnjë ndezur, edhe ditën", shpjegon D'Amico.



| | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Autor: GAZMEND MORINA | ENERGJIK, I SHKATHËT | NGJALLJE E KUJTIMEVE PËR DIKË (sh.shq.) | LLOJ DEVE E VENDEVE TË AMERIKËS JUGORE (sh.shq.) | ALBANOLOGIA .... DURHAM | GROUP INTERACTIVE NETWORKS | PJESËTAR I NJË FISI ILIR | PJESËTAR I NJË POPULLI NË SRI LANKË | EPOKA E RE | SHTËPIA E BANIMIT | SHKRIMTARI .... ZOLA | “... VEGAS” |
| | | | | | | PËRFAQËSUES I ZGJEDHUR NGA NJË ORGANIZATË | | | | | | | | PJESA MË E NGUSHTË E TRUPIT TË NJERIUT, MESI (pashq.) | | | |
| | | | | | | I UJITA | | | | | | | | GURRA | | | |
| | | | | | | EMËRIM NË NJË DETYRË / FUQI, FORCË (krah.) | | | | | | | | FILLOJ / NËNSHTRIM I PLOTË | | | |
| | | | | | | → | | | | | LARTËSI E NJË LËNGU NË NJË ENË / FLORI, DUKAT | | | | | | LIQEN I MADH NË AMERIKËN JUGORE |
| | | | | | | GOJËDHËNË | | | | PËRMBLEDH-JE HARTASH GJEOGRAFIKE / VEÇORI THELBËSORE E NJË SENDI | | | | | | BASHKËT. / ORGAN I FEMRËS, GJI (shq.) | |
| | | | | | | ISMET MUNISHI | | | DIREK I ÇATISË / VLERËSIMI I NXËNËSIT ME NOTË | | | | VËLLIMI, MASË / GUID PARTITION TABLE | | | | |
| | | | | | | SHTET NË AFRIKË (pashq.) | | | | | PREJ KU / LUTJA QË I BËHET ZOTIT (mysl.) | | | | IGLI TARE / ZANORE | | |
| EPOKA E RE | TRAJNERI I FUTBOLLIT NË FOTO | QILIM I VOGËL QË SHTROHET NË NJË ANË TË OXHAKUT (shq.) | VENDI KU NDIZET ZJARRI | ALYSSA MILANO | FUTBOLLIST I NJOHUR PORTUGEZ (MANCHESTER UNITED) | DIPLOMATI FINLANDEZ ... REHN | ARMË E RËNDË LUFTE / ISH FUTBOLLISTI ZIDAN | | | | | QELESHJA / DIJETARI FETAR MYSLIMAN | | | | | |
| ENË QELQI E RRUMBULLAK-ËT SI SHISHE, PO ME GRYKË TË GJERË E ME KAPAK | | | | | | | | ARKIVOLI | | | | | | | ADRIAN KRASNIQI / BASHKËT. | | |
| ARKEOLOGU YNË SKËNDER | | | | | | | | INTENSTET, RADIUM, LITËR / SHALQI | | | | | LLOJ REVOLEJE / BASHKËT. | | | ZANORE / GDHENDA | |
| RITUAL | | | | AGJËRIM (krah.) / REPARTI I SPITALIT KU LINDIN FOSHNJAT | | | | | | KAFSHË SHTËPIAKE PËRTYPËSE E IMËT / DY BASHKË-TINGËLLORE | | | | | DY BASHKË-TINGËLLORE / REGJISORI ..... STONE (shq.) | | |
| TË QENËT I LARMË, TË QENËT LARA-LARAMANI | | | | | | REPER I NJOHUR AMERIKAN / OHAJO, LUIZIANA | | | | | | | NJË PLANET / BASHKËT. | | | | |
| ZANORE | | ALI ALIU / KËNGËTARJA ME FAMË BOTËRORE ..... ROSS | | | FUTBOLLISTI ITALIAN MASIMO ... / AGIM TEJECI | | | | YLL FILMI / I TURPËROJ | | | | | NOTË MUZIKORE / DANISH AIR TRANSPORT | | | QË NXË NJË OKË (shq.) |
| AFËRDITA DRESHAJ | | | KRYEQYTETI I ESTONISË / BREJTËS I VOGËL | | | | | | | ISMET JASHARI / I SHASTISUR; I HUTUAR | | | KËNGËTARJA ROVENA .... / VITI I RI KINEZ (pashq.) | | | | |
| BEREQET | | | | | | MODELJA AMERIKANE .... TAYLOR / TEFTA TASHKO | | | | | QË KA TË BËJË ME ATAVIZMIN / FRIKACAKU, IKANAKU | | | | | | |
| LAGJE NË SHKUP | | | | | TROYES / SOLISTJA BYTYQI | | TRUP GJEOMETRIK / VEZAKE | | | | | PARA TË NËNTËS / ELEKTRON, TANTAL, REOMIR | | | | | |
| ESTONIA, NORVEGJIA | | | PESHA E MALLIT PA AMBALAZH / MAJA E MPREHTË E NJË MALI (sh.shq.) | | | | | HARAÇ / RAVENA | | | | | | RADIUM, TON / GATESË E JONA (sh.shq.) | | | |
| LAKESË | | | | | | ZGAVËR NË TOKË (sh.shq.) / DEM, TER | | | | | | | 3.14 (Mat.) / SHEGË | | | ZANORE / KËNGËTARI AMERIKAN .... BROWN (shqip.) | |
| OTRANTO | | VENDLINDJA E ODISEUT / MA JEP | | | | | | VIGANI, KOLOSI / BASHKIM QELIZASH TË NJËLLOJTA | | | | | | | KADRI ROSHI / NJËSIA E REZISTENCËS ELEKTRIKE | | |
| KËNGËTARJA JONË ANITA .... | | | | | LETRARI PODRIMJA / ALUMIN | | | | LLOJ KOSI ME HUDHRA / DRITA OSMANI | | | | | | | | |
| I PESHOVA | | | | | | PUNUAR NË VEGJË (PËLHURË A RROBË) / ZANORE | | | | | | BAKRI / SUEDIA | | | | | ZANORE |
| EPOKA E RE | PRIJËS I HUNËVE | | | | | | EURO DEPUTETJA ..... PACK | | | | | | LUMË I MADH NË HUNGARI | | | | |

# Qyteti më i mirë në Evropë për të punuar dhe për t'u kënaqur

## Pse ky konsiderohet si kryeqyteti më i mirë evropian për të punuar dhe për t'u kënaqur



Lennox MORRISON

Një qytet që ende po kërkon të rimëkëmbet pas krizës në Eurozonë që goditi ekonominë kombëtare, Lisbona po punon fort për të mbështetur bizneset e ngritura nga shtëpia për të tërhequr sipërmarrësit pa përvojë nga e gjithë bota.
Në tre vjetët e fundit, mbështetja e këshillit për bizneset e reja ka ndihmuar qytetin të fitojë titullin Rajoni Evropian Sipërmarrës i vitit. Në të njëjtën kohë, qyteti i është nënshtruar edhe një ndryshimi: pronat e shkatërruara të qendrës janë zëvendësuar me dyqane e kafene të reja.
"Ndryshimi ka qenë dramatik", tha Rui Coehlo, drejtori ekzekutiv i "InvestLisboa", një agjenci promovimi investimesh në Lisbonë. "Ne pamë investime në kohë rekord në pasuri të patundshme, turizëm, dhe sipërmarrje në vitin 2015, ishte fantastike. Megjithatë nuk jemi të vetëkënaqur, papunësia është ende e lartë dhe me rehabilitimin e qendrës së qytetit kemi ende shumë për të bërë".
"StartUp Lisboa", e themeluar në vitin 2011 ka ndihmuar në krijimin e më shumë se 250 bizneseve. Rreth 30% e sipërmarrësve të rinj janë të huaj. "Për shkak të evolucionit teknologjik, njerëz të talentuar mund të punojnë dhe të jetojnë kudo në mënyrë që ata të zgjedhin një vend të mirë për të jetuar dhe me siguri Lisbona është një nga këto vende", tha ai.
I vendosur në bregun e Atlantikut ky qytet port ka një kapital relativisht te vogël me 548,000 njerëz, me plazhe me rërë të artë dhe 220 ditë me diell në vit. Lisbona ofron një kulturë sërfi dhe golfi në vende piktoreske ku anglishtja flitet gjerësisht. Gjithashtu shpenzimet janë relativisht të ulëta në krahasim me kryeqytetet e tjera të Evropës Perëndimore.
Pa industri të rënda, sektori i shërbimit atje është gjithçka. Në qendrat e shërbimit janë përfshirë kompani nga e gjithë bota si "Fujitsu", baka franceze "BNP Paribas", "US IT" etj. Qyteti tërheq në më shumë se katër milionë vizitorë në vit, me rreth 40% prej tyre që vijnë për biznes.



### Kultura mikse

Ky kapital relativisht i vogël operon me një përzierje delikate kulturash. "Shpesh në SHBA, kur i kërkon një takim ndonjërit, ata shohin kalendarin dhe thonë: A takohemi për tre javë? Por në Lisbonë njerëzit thonë "Patjetër, takohemi pasdite për një kafe?", thotë Maurren Ferguson, një konsulent ushqimesh dhe pijesh, i cili kohët e fundit u zhvendos në Lisbonë nga Filadelfia.
"Njerëzit janë të ngrohtë dhe miqësorë, dhe anglishtja e tyre është spektakolare ,por miqësia duhet fituar. Të duhet pak kohë përpara se të fillosh të ndash informacione personale. Akull thyesi i përsosur është të nisësh biseda në lidhje me kuzhinën tradicionale dhe verërat", thotë Ferguson.
Pjesërisht për shkak të krizës financiare, tani ka një hapje të dukshme për ide të reja në qytet. Eksiton një shpirt i vërtetë sipërmarrjeje në Lisbonë tani. Njerëzit e duan traditën, por janë edhe të hapur për gjëra të reja. Gjatë krizës shumë njerëz gjetën mundësi për të jetuar kudo dhe të zbulonin mënyra të ndryshme për të bërë gjëra. Tani po ka më shumë mundësi që të kthehen dhe të sjellin energji të tjera me vete.

### Aeroporti

Rreth 7 km në veri të qendrës së qytetit ndodhet aeroporti modern, kryesor i Portugalisë me lidhje direkte në 43 vende dhe 110 destinacione ku përfshihen dhe vende afrikane apo amerikanojugore.

### Çështjet e parave

"Amex"-i dhe "Visa" pranohen gjerësisht, "Mastercard"-i përdoret më pak, por është e përdorshme për të mbajtur rreth 50 euro kesh për blerje të vogla si ushqim apo taksi. Një kafe kushton 60-80 cent. Do të kushtojë më shumë nëse shkoni në një vend turistik. Nuk ka nevojë për bakshishe nëse ha ndonjë gjë të vogël apo pi kafe.

### Hotelet

Hotelet janë kollaj të gjindshme dhe mund të shkosh edhe nëpërmjet metrove. Ndër kryesoret janë "Marques de Pomal", "Avenida da Liberdade" dhe shumë të tjera që ofrojnë të gjitha lehtësitë që i nevojite një turisti. Dhomat kushtojnë nga 106 euro nata përfshi parkimin.

### Jeta natës

S'do të ishte mirë të largoheshit nga Lisbona pa dëgjuar, muzikë tradicionale portugeze Fado. Po të shkoni në rrethe historike si Alfama apo Bairro Alto, do të gjeni ndonjë klub ku luhet muzikë Fado. Në këto klubi ofrohet dhe kuzhinë kombëtare me ushqimet më të mira të zonës.

("BBC")













Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# 'Dugi', mes Dukagjinit dhe Besës

Mesfushori Dugagjin Gashi është lojtar i lirë, por ofertat në adresë të tij nuk janë të pakta. E ardhmja pritet të zyrtarizohet brenda javës, kurse favorite për shërbimet e tij mbesin Besa e Pejës dhe Dukagjini i Klinës. "Ofertat nuk më mungojnë. Kontrata me Dukagjinin më ka përfunduar dhe tash jam lojtar i lirë, por brenda javës do ta bëj publike emrin e skuadrës së re", ka thënë Gashi



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Dugagjin Gashi është një nga mesfushorët me përvojën më të madhe në futbollin e Kosovës, kurse aktualisht është lojtar i lirë. "Dugi" edicionin e fundit mbrojti me sukses ngjyrat e Dukagjinit dhe ishte ndër lojtarët më meritor për inkuadrimin e skuadrës nga Klina në Superligë.

I kontaktuar të dielën nga gazeta "Epoka e re", Gashi ka konfirmuar se është në bisedime me disa skuadra, por e ardhmja e tij do të bëhet zyrtare në ditët e para të muajit korrik. "Ofertat nuk më mungojnë. Kontrata me Dukagjinin më ka përfunduar dhe tash jam lojtar i lirë, por brenda javës do ta bëj publike emrin e skuadrës së re", ka thënë Gashi, i cili ka zbuluar se Besa e Pejës e ka kontaktuar deri tash, kurse me skuadrën e Dukagjinit ende nuk ka biseduar. "Mund të zbuloj se ende nuk kam biseduar me drejtuesit e Dukagjinit dhe gjasat janë që të mbetem pjesë e kësaj skuadre. Më kanë kontaktuar disa skuadra. Edhe Besa. Klubi i qytetit tim është i interesuar që unë të rikthehem dhe normalisht se është një opsion shumë i mirë", ka shtuar Gashi, i cili ka arritur shumë suksese me klubin pejan. Mesfushori Dugagjin Gashi ka një histori interesante si futbollist, pasi vetëm dy vjet ka luajtur në Ligën e Parë, kurse pjesën tjetër të karrierës e ka kaluar nëpër skuadra të Superligës. Mirëpo Gashi në kohën kur ka luajtur në Ligën e Parë ka arritur suksese të jashtëzakonshme, pasi i ka rikthyer në elitë fillimisht Feronikelin dhe në edicionin e fundit Dukagjinin. "Kam luajtur për shumë klube në Superligë dhe Ligën e Parë. Në këtë të fundit dy herë arrita suksese të jashtëzakonshme, duke inkuadruar skuadrat në rangun më të lartë të futbollit. Pavarësisht pjesë e cilës skuadër apo ligë jam, gjithmonë angazhohem maksimalisht për t'i arritur objektivat me skuadrat ku luaj", ka shtuar ai.

Mesfushori Dukagjin Gashi pjesën më të madhe e ka kaluar në Besën e Pejës, kurse ka djersitur edhe fanellën e Vëllaznimit, Istogut, Drenicës, Feronikelit dhe Dukagjinit të Klinës.

## SHKURT

### Vushtrria e rikthen Shotanin

Skuadra e promovuar në IPKO Superligë, Vushtrria, para disa ditësh ndau rrugët me trajnerin Samuel Nikajn. Ndërsa të dielën e ka zyrtarizuar marrëveshjen me trajnerin Bekim Shotani. Shotani vlerësohet në Vushtrri trajner historik, kurse ka drejtuar edhe Ballkanin, Drenicën dhe Llapin. "Bekim Shotani do të na udhëheqë në edicionin e ri 2019/20. Ne i urojmë shumë suksese trajnerit tonë historik", thuhet në njoftimin e Vushtrrisë.

### Broja nënshkruan për Partizanin

Mesfushori Rron Broja do ta vazhdojë karrierën në Superligën e Shqipërisë, te kampionët e Partizanit. Skuadra kampione e Shqipërisë ka njoftuar se ka arritur marrëveshje me 23-vjeçarin që sezonin e fundit ishte pjesë e FC Shkupit në Maqedoninë Veriore. "Klubi i Futbollit Partizani zyrtarizon arritjen e marrëveshjes me Rron Brojën. Mesfushori i talentuar do të jetë pjesë e skuadrës për dy vjetët e ardhshëm, pasi ka nënshkruar kontratën me kampionët e Shqipërisë. 23-vjeçari nga Kosova vishet i kuq pas përvojës pozitive te FC Shkupi. Njëkohësisht Broja ka luajtur me skuadra si Gent II, SK Deinze në Belgjikë dhe Trepça '89. Gjithashtu, ka qenë pjesë edhe e ekipeve kombëtare U-21 të Shqipërisë dhe Kosovës. Mesfushori i talentuar do t'u bashkohet të kuqve menjëherë pas mbërritjes së ekipit në kryeqytet", thuhet në njoftimin e Partizanit.

### Brooklyn shumë afër marrëveshjes me Irvingin

Basketbollisti Kyrie Irving do ta vijojë karrierën tij në Nju Jork, pasi është afër mbylljes së marrëveshjes me Brooklyn Netsin. Parashikohet se Irvingu do të nënshkruajë kontratë katërvjeçare dhe do të përfitojë gjithsej 141 milionë dollarë. Basketbollisti i cili ka qenë gjashtë herë pjesë e All Star Games e mbylli sezonin e fundit me Celticsin duke regjistruar një mesatare prej 23.8 pikësh të realizuara, 6.9 pasime vendimtare dhe 7 topa të kapur në tabelë.

## Verstappeni fitoi Çmimin e Madh të Austrisë

VJENË, 30 QERSHOR - Max Verstappen është fituesi i Çmimit të Madh të Austrisë në pistën e "Red Bull Ring". Piloti holandez zhvilloi garë madhështore duke parakaluar dy xhiro para fundit Charles Leclerc, që kryesoi garën nga starti e deri në fund, teksa u duk se piloti i ri i Ferrarit do ta fitonte garën e parë në karrierë. Starti ishte i mirë për pilotët kryesues, që arritën t'i mbrojnë pozicionet e tyre, ndërsa Sebastian Vetteli, i nisur nga vendi i 9-të, arriti të përfitojë tre pozicione që në start. Me kalimin e xhirove Vetteli arriti ta kapë pozicionin e tretë, edhe falë pit-stopit të detyruar për Hamiltonin, i cili ndërroi hundën e makinës. Ndërkohë që Leclerc dhe Bottas vijuan të kryesojnë të qetë deri në 10 xhiro para fundit. Verstappeni që kaloi të gjithë pilotët një e nga një duke u ngjitur në vend të dytë dhe dueloi me pilotin e Ferrarit, derisa e parakaloi dy xhiro para fundit, madje e shtyu duke e nxjerrë jashtë piste. Në xhiron e fundit Sebastian Vettel e mbylli me një parakalim ndaj Hamiltonit, duke i marrë vendin e katërt në renditje.



## Kosova debuton me një fitore dhe një humbje në garat e 3X3

Prishtinë, 30 qershor - Kosova ka debutuar në garat 3x3 të kualifikimeve në FIBA Europe Cup që u zhvilluan në Konstanca të Rumanisë. "Dardanët" në ndeshjen e parë u ballafaquan me superfuqinë botërore në këtë sport, Sllovetinë. Përkundër angazhimit, sllovenët ishin më të mirë dhe shfrytëzuan përvojën e tyre në këtë garë, duke fituar në fund me rezultat 21:8. Arti Hajdari shënoi katër pikë për Kosovën në këtë ndeshje. Më pas Kosova u takua me Andorrën, ku dominoi totalisht, duke fituar bindshëm 21:6. Kosova ishte më e mirë gjatë gjithë ndeshjes dhe rezultati ka mundur të jetë edhe më i lartë. Arti Hajdari shënoi tetë pikë në këtë ndeshje, Altin Sahiti 6, Albatrit Berisha 4 dhe Arian Mehmeti 3. Kështu Kosova debutoi me një fitore dhe një humbje, duke u renditur e dyta, që është një sukses duke marrë parasysh se ishte hera e parë që merr pjesë në gara të tilla. Ekipi i Kosovës përbëhej nga Altin Sahiti, Albatrit Berisha, Arti Hajdari dhe Arian Mehmeti, kurse koordinator ishte Agon Fehmiu.



# Historia e Bakus i përsëritet Karaqit edhe në Minsk

Prishtinë, 30 qershor - Alvin Karaqi ka mbetur tejet i mërzitur me mënyrën se si nuk arriti të fitojë medalje në Lojërat e dyta Evropiane "Minsk 2019". Karateisti Karaqi ishte pranë medaljes, por në sekondën e fundit ukrainasi Valerii Chobotov e mposhti me Ippon, duke e kthyer rezultatin nga 3:1 për Alvinin në 3:4. Ai më pas mposhti malazezin Nikola Maleviq, por humbja edhe ndaj kroatit që u shpall kampion, Ivan Kvesiq, bëri që të mos kualifikohet në gjysmëfinale, ku e priste të paktën medalja e bronztë. Sipas Karaqit, fati i njëjtë me Lojërat Evropiane "Baku 2015" iu përsërit edhe të shtunën. "Historia u përsërit. Në Baku 3 sekonda, ndërsa në Minsk 2 sekonda më ndanë nga medalja. Nuk kam fjalë ta përshkruaj se sa e rëndësishme ka qenë kjo garë për mua, duke marrë parasysh se në çka kam kaluar vitin e fundit, nga operimi e deri këtu. Nuk isha në më të mirën time, por arsyetime humbësit kanë gjithmonë. Prandaj, i uroj Kosovës me gjithë zemër 3 medaljet në këto lojëra duke shpresuar për më shumë çdo garë e tutje", ka shkruar Karaqi në "Facebook". Alvini zuri vendin e tretë në grupin B të kategorisë -84 kilogramë, duke lënë pas medalistin e bronztë evropian Maleviq, të cilin e mposhti në luftën e tretë. Ai në Baku kishte dalë i katërti, kurse medaljet u kishin takuar vetëm tre të parëve, kurse në "Minsk 2019" u ndanë medalje për katër të parët.



# Vinales me Yamahan triumfon në Holandë

Amsterdam, 30 qershor - Piloti spanjoll Maverick Vinales me Yamaha fitoi sot garën e Çmimit të Madh të Holandës në Moto GP, zhvilluar në pistën e Assenit. Ky është triumfi i parë i motorit japonez për këtë sezon, duke thyer kështu tersin dhe rikthyer te fitorja pas më shumë se një viti. Në vendin e dytë u rendit kampioni i botës në fuqi, spanjolli Marc Marquez me Honda, ndërsa në vendin e tretë u klasifikua francezi Fabio Quartararo me Yamaha Petronas. Këta tri pilotë dueluan më së shumti mes tyre për fitoren, por në tetë xhirot e fundit mes tyre u krijuan dallime të mëdha dhe Vinales fitoi me lehtësi. Gjithsesi, nëse Yamaha e spanjollit funksionon mirë, ajo e Valentino Rossit po zhgënjen. Piloti italian u rrëzua në xhiron e katërt pas një kontakti me Nagakamin, që pati një aksident të frikshëm, por pa pasoja (ndodhet në qendrën mjekësore të pistës). Dobët u paraqit edhe motori Ducati, që asnjëherë nuk dueloi dot për fitoren. Dovizioso u klasifikua i katërti, por ishte 14 sekonda më i avashtë se fituesi. Gjithsesi, pas kësaj gare vijon të dominojë në renditjen e përgjithshme Marc Marquez, që shkëputet edhe më shumë karshi rivalëve, 44 pikë nga Dovizioso. Gara e radhës, pas një jave në Gjermani.




## SHKURT

### Gashi, afër Grasshoppersit

Sulmuesi shqiptar Shkëlzen Gashi ka tre muaj që ka mbetur futbollist i lirë pasi ka ndërprerë kontratën me skuadrën amerikane Colorado Rapids. Gashi duket pranë rikthimit në futbollin zvicëran, më saktësisht tek ish-skuadra e tij Grasshoppers. Skuadra më e trofeshme zvicerane ka rënë në Challange League dhe synon ta ndërtojë një ekip cilësor për t'u rikthyer në elitën e futbollit zvicëran. Sipas medieve zvicerane, marrëveshja mes palëve është afër dhe Gashi pritet të nënshkruajë një kontratë dyvjeçare. Gashi gjatë karrierës së tij ka luajtur edhe për Baselin, Zurichun, Xamaxin, Aaraun, Bellizonën dhe Schaffhausenin.

### Chelsea kërkon 55 milionë euro për Moratan

Atletico Madridi duhet ta aktivizojë opsionin për blerjen e kartonit të sulmuesit Alvaro Morata, përndryshe ai do të kthehet në "Stamford Bridge", një kusht ky që nuk pritej aspak nga drejtuesit e "Los Colchoneros". Sipas asaj që publikohet te 'Telegraph', blutë e Londrës nuk kanë ndërmend të bëjnë asnjë lëshim dhe i kanë kërkuar Atleticos t'i paguajë menjëherë 55 milionë euro që është klauzola e kontratës së futbollistit edhe pse në merkaton e janarit ai u transferua tek Atletico për 18 muaj. Sipas marrëveshjes mes dy klubeve, Atletico mund të paguajë këtë klauzolë në fund të sezonit 2019/2020, por anglezët mund të kërkojnë të paguhen për Moratën më shpejt.

### Silva, kapiteni i ri i Manchester Cityt

Pak ditë më parë David Silva mori vendimin se edicioni 2019-2020 do të jetë i fundit për të me Manchester Cityn, madje duke refuzuar edhe rinovimin me dy vjet të kontratës, për të firmosur vetëm për 1 vit pasi në 2020-n nuk e shikon më veten të denjë për ta mbajtur veshur fanellën e një klubi të madh si "Citiziens". Për ta shpërblyer David Silvën drejtuesit e kampionëve të Anglisë, me kërkesë edhe të trajnerit Pep Guardiola, kanë vendosur ta gradojnë spanjollin kapiten të ri të skuadrës me David Silvën që do ta marrë trashëgiminë e lënë nga Vincent Kompany.

### Reali, 95 milionë euro për Asension

Pas fitimit të Ligës së Kampionëve, tek Liverpooli nuk kanë ndërmend të ndalen. Sipas asaj që shkruan "Sunday Express", Jurgen Kloppi ka kërkuar ndërhyrje në merkato dhe lojtari që pëlqehet është ylli i Real Madridit, Marco Asensio. Pas merkatos së fuqishme te Reali, drejtuesit "LosBlancos" janë të gatshëm për të nisur një marrëveshje për shitjen e 23-vjeçarit. Klopp dëshiron një skuadër të fortë për sezonin e ri dhe spanjolli shihet si një përforcim shumë i fortë. Mësohet se drejtuesit e "The Reds" do të paguajnë një shumë rreth 95 milionë euro për ta pasur lojtarin në skuadrën e tyre.

## Republika e Kosovës

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria – Vlada - Government*

*Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite Ministry of Labour and Social Welfare*

**Mbështetur në nenin 13 dhe 18 të Ligjit Nr. 03/L - 149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe në Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, shpall:**

**Titulli i vendit të punës: Asistent Administrativ** (1 pozita)/zavendësim pushim të lehonisë
**Referenca: AD/200**
**Zyra e Drejtorit të DFSHP**
**Kategoria funksionele: Niveli administrativ**
**Koeficienti: 6** (gjashtë)
**Orari i punës: I plotë, 40 orë në javë**
**Akt Emërimi: Sipas Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës**
**Procedura e aplikimit: I jashtëm**
**I përgjigjet: Drejtorit të DFSHP**
**Vendi: Prishtinë**

**Qëllimi i vendit të punës**: Ofrimi i përkrahjes administrative dhe teknike për stafin profesional dhe drejtues të Zyrës së Drejtorit të DFSHP në fushat kryesore të punës

**Detyrat dhe kryesore**:

**1**. Ndihmon stafin Profesional dhe Drejtues në një numër të detyrave të rëndësishme dhe të shkathëta teknike/administrative (shpesh pa mbikëqyrje); kryen të gjitha punët në kohë dhe në mënyrë të saktë;
**2**. Merr përgjegjësi specifike, pa mbikëqyrje, për zbatimin e një numri të procedurave dhe udhëzimeve administrative përmes vet-iniciativës kur kërkohet; përfshirë trajtimin e rregullt në mënyrë të pavarur të çështjeve të paparapara me udhëzime por të ndërlidhura me nevojat e institucionit;
**3**. Mban regjistër të saktë dhe të plotë të aktiviteteve, dosjeve, punimeve, dokumenteve zyrtare, etj., përfshirë përgatitjen e raporteve dhe analizave statistikore;
**4**. Mban kontakte të rregullta me punonjësit në të gjitha nivelet e institucionit, stafin e institucioneve tjera dhe publikun, përfshirë ofrimin e ndihmës dhe këshillave e udhëzimeve për çështje të caktuara ose shkëmbim të informatave;
**5**. Menaxhon kalendarin e takimeve dhe ngjarjeve tjera për mbikëqyrësin si dhe ndihmon në zgjidhjen e ndonjë problemi administrativ dhe teknik
6. Ndihmon në adresimin e pyetjeve nga menaxherët dhe stafi në lidhje me procedurat teknike ose administrative të cilat mund të jenë mjaft të komplikuara;
**7**. Kryen detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

**Kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe shkathtësitë e tjera**:
Diplomë e shkollës së mesme, përvojë pune tri (3) vjetë në fushën administrative dhe teknike, trajnime përkatëse në këto fusha;
Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës;
Shkathtësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;
Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel);

**Konkursi mbetet i hapur 15** (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor dhe në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), nga data **01.07.2019**deri më **15.07.2019**.

**Formularët për aplikim merren në divizionin për burime njerzore/MPMS dhe të plotësuara dorëzohen, çdo ditë pune nga ora 08:00-16:00, adresa: Rruga "Edit Durham" Nr. 46-Prishtinë, afër sheshit"Zahir Pajaziti"ndërtesa e MPMS-së. Aplikacioni mund të shkarkohet nga ueb-faqe http://mpms-gov.net/**

Aplikacionet e dërguara me postë te cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën ditën e fundit të afatit për aplikim do të konsiderohen të vlefshme nëse arrijnë brenda 4 (katër) ditësh. Aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Aplikacionit i bashkangjiten kopje të dokumentacionit mbi kualifikimin, për përvojen e punës, dokumente tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilën konkurrojnë kandidatët.

Kandidatët që ftohen në intervistë janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale për verifikim para komisionit intervistues.

Kandidatët që hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën nëpërmjet telefonit ose me shkrim në afat ligjor nga zyra e personelit..

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundesi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femrore nga të gjitha komunitetet në Kosovë .

## Republika e Kosovës

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria – Vlada - Government*

*Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite Ministry of Labour and Social Welfare*

**Na osnovu članova 13 i 18 Zakona br. 03 / Z-149 o Civilnoj Službi Republike Kosovo, i Uredbi br. 02/2010 o Procedurama Rekrutovanja u Civilnoj Službi, Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite objavljuje:**

**Naziv Radnog mesta: Administrativni Asistent** (1 pozicija ) **na zamenu porodiljskog odmora**
**Referencija : AD/200**
**Kancelarija Direktora DFOU**
**Funkcionalna kategorija: Profesionalni nivo**
**Koeficijenti: 6(šest)**
**Radno vreme: punih 40 sati nedeljno**
**Akt o imenovanju: Prema Zakonu o Civilnoj Službi Republike Kosovo**
**Postupak prijave: Spoljni**
**Odgovora: Direktoru DFOU**
**Mesto**:Pristina
**Svrha radnog mesta** :Obezbediti administrativnu i tehničku podršku stručnom osoblju i Rukovodiocima Kancelarije Direktoru DFOU u ključnim oblastima rada

**Glavni zadaci:**
1. Pružanje pomoći profesionalnom i rukovodećem osoblju u nizu važnih i veštih tehničkih / administrativnih zadataka (često bez nadzora); obavlja sve radove na vreme i ispravno;
2. Preuzima specifičnu, bez nadzora, odgovornost za sprovođenje niza administrativnih procedura i instrukcija kroz samoinicijativu kada je to potrebno; uključujući redovno postupanje sa nepredviđenim pitanjima sa uputstvima, ali vezano za potrebe institucije;
3. Održavati tačno i potpuno registar aktivnosti, dosijea, radova, zvaničnih dokumenata, itd., Uključujući pripremu statističkih izvještaja i analiza;
4. Održavati redovne kontakte sa zaposlenima na svim nivoima ustanove, osobljem drugih institucija i javnosti, uključujući pružanje pomoći i saveta i uputstva o određenim pitanjima ili razmeni informacija;
5. Upravljati kalendarom sastanaka i drugim događajima za nadzornim i pomaže u rešavanju administrativnih i tehničkih problema;
6. Pomažu u rešavanju pitanja menadžera i osoblja u vezi sa tehničkim ili administrativnim procedurama koje mogu biti prilično komplikovane;
7. Obavljanje i druge dužnosti u skladu sa važećim zakonima i propisima koji se s vremena na vrjeme mogu razumno zahtevati.

**Kvalifikacija, radno iskustvo, veštine i druge veštine**:
Diploma srednje škole, radno iskustvo tri (3) godine u administrativnoj i tehničkoj oblasti, relevantne obuke u ovim oblastima;
Sposobnost sprovođenja administrativnih procedura i uputstava za obavljanje dužnosti;
Veštine komunikacije, uključujući sposobnost da se tumače informacije, pružaju uputstava i prenositi informacije drugima;
Kompjuterske veštine u programskim aplikacijama (Word, Excel)

**Konkurs ostaje otvoren 15** (petnaest) dana od dana objavljivanja u dnevnoj štampi, u Informacionom Sistemu za Upravljanje Ljudske Resurse,(ISULjR) od **01.07.2019** do**15.07.2019. Obrazci za prije uzeti u Diviziji Ljudskim Resursima MRSZ u prizemlje,i popunjene dostavljati, svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Adresa: Ulica "Edit Durham" u blizini , trga "Zahir Pajaziti" zgrada MRSZ-te u Prištini, aplikacija se može preuzeti sa http://mpms-gov.net/**

Aplikacije koje su poslate poštom koja drže poštanski žig na pošiljci poslednjeg dana roka za prijavu smatraće se važećim ako dostignu u roku od 4 (četiri) dana. Aplikaciji dostaviti kopije kvalifikacione dokumentacije, radno iskustvo i druga neophodna dokumenta koja zahteva radno mesto za koje kandidati konkurisu . Nepotpune aplikacije neće biti pregledane.
Kandidati pozvani na intervju su obavezni da sa sobom donesu originalnu dokumentaciju za verifikaciju pred komisijom za intervju .

Kandidati koji ulaze u bliskoj selekciji će biti obavešteni o intervju telefonom ili pismenim putem u zakonskom roku od kancelarije osoblja.

Kosovska Civilna Služba nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo i pozdravlja prijave svih polova muškaraca i žena iz svih zajednica na Kosovu.

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova – University Clinical Center of Kosovo
**Sektori i Personelit**

Nr.Ref. 26/2019-06/2, datë 10.06.2019.

Në bazë të nenit 13 pika 3 e Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, nenit 13 pika 1 e Statutit të QKUK-së, nenit 6 pika 5.1, të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, dhe Rekomandimit të Kryesuesit të Komisionit përzgjedhës nr. 1462/3 të datës 26.06.2019, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, nxori këtë:

**V E N D I M**
**Për Anulim të Konkursit publik,**

I. **Anulohet në tërësi** Konkursi publik nr. 1462, datë 10.06.2019 për Embriolog për Laboratorin në Klinikën Obsetrike dhe Gjinokologjike, dy pozita në QKUK;
II. Obligohet Sektori i Personelit për zbatimin e këtij Vendimi;
III. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Komisioni Përzgjedhës i caktuar sipas Vendimit nr. 1462/2 datë 12.06.2019, me Rekomandimin nr. 1462/3 datë 26.06.2019, njofton që ky konkurs të anulohet në tërësi për arsye se nuk ka kandidatë të mjaftueshëm sipas nenin 6 pika 5.1 e Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Proceudrave të Konkursit në Sektorin Publik, komisioni kërkon anulimin e tij, të modifikohet më mirë dhe i njejti të publikohet sa më parë që të jetë i mundur.

Prandaj, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, në bazë të kompetencave, konform ligjit në fuqi dhe kërkesës në fjalë, lejon anulimin e Konkursit publik për Embriolog për Labaratorin në Klinikën Obsetrike dhe Gjinokologjike (dy pozita në QKUK) të modifikohet më mirë dhe i njejti do të publikiohet sa më parë që të jetë i mundur.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

VENDIMI T'I DORËZOHET
- ✓ Zyrës së personelit,
- ✓ Një mediumit informativ.
- ✓ Arkivit.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova – University Clinical Center of Kosovo
**Sektori i Personelit**

Nr.Ref. 26/2019, data 10.06.2019.

U skladu sa članom 13 stav 3 Statuta Kosovske bolnice i službe za kliničku bolnicu, članom 13 tačka 1 Statuta UKCK, članom 6 tačka 5.1, Administrativno Uputstvo (MRSZ) br. 07/2017 o Regulisanju Postupaka Konkursa u javnom sektoru, i Preporuka predsednik Komisije za izbor br. 1462/3 na dan 26.06.2019. godine, Generalni Direktor UBKSK-a izdao je sledeće:

**O D L U K A**
**Za poništenje (anulira) javnog konkursa**

I. Ukinut u punom javnom konkursu br. 1462, od 10.06.2019. za embriologa za labaratora na akušerskoj i ginekološkoj klinici, dvije pozicije u UKCK-u

II. Sektor kadrova je obavezan da primeni ovu Odluku;

III. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

**O b r a z l o ž e n j e**

Komisija za izbor dodeljena odlukom br. 1060/2 od 12.06.2019, sa Preporukom br. 1062/3 od 26.06.2019. Godine, izveštava da se ovaj konkurs treba u potpunosti poništiti jer nema dovoljno kandidata prema člana 6 tačka 5.1 Administrativnog Uputstva (MRSZ) br. 07/2017 o regulisanju postupka javnog konkursa, Komisija traži njeno poništenje, bolje modifikovana i objavljena što je prije moguće.
Shodno tome, Generalni Direktor UBKSK, prema nadležnostima, prema važećem zakonu i preporuke komisije, dozvoljava poništenje javnog konkursa, za embriologa za labaratora na akušerskoj i ginekološkoj klinici, dvije pozicije u UKCK-u, i zahtijeva bolje modifikovana i objavljena što je prije moguće.

Kao što je već navedeno, odlučeno je kao u dispozitivu ove odluke.

ODLUKA KOJI SE PODNOSI
- * Kancelarija za kadrove,
- * Informacioni medij.
- * Arhiva.

Generalni Direktor UBKSK.

Dr. Basri Sejdiu




## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Kafe - Piceria " Oxhaku" shpall te pavlefshme certifikaten e biznisit 70384927 dhe NF " 600077871 Prizren
- ▶ "Baron - A " ShPK. Me numer biznisi 810983569 ne Prizren ben likuidimin e mallit duke filluar me daten 01.07 .2019 Prizren

- ▶ Fatmir Sylejmani shpallë të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme " Hoxhë Kadri Prishtina" Prishtinë.
- ▶ Besnik Xhemajlaj shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Anton Çetta" Skenderaj, drejtimi Ekonomi dhe Financa.
- ▶ Mimoza Rexhepi nga Prishtina shpall të pavlefshme tri dëftesat, certifikatën dhe Diplomën e lëshuar nga shkolla "Hoxhë Kadri Prishtina" në Prishtinë.
- ▶ D.P. "BURGER SHOP" me seli në Prishtinë, shpall të pavlefshëm certifikatën e biznesit me numër: 71120481 dhe numër fiskal: 601197248.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi52 000€. Për info 044/672-439.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L